



**USAID**  
FROM THE AMERICAN PEOPLE



MACEDONIAN  
CIVIC  
EDUCATION  
CENTER



Projekti për integrim ndëretnik në arsim

# **AKTIVITETE TË PËRBASHKËTA ME GRUPE TË NXËNËSVE ME PËRBËRJE TË PËRZIER ETNIKE /GJUHËSORE**

**projekt doracak për mësimdhënësit  
-për përdorim intern**

**Shkup, tetor 2012**

---

Doracaku është përgatitur nga ana e Qendrës për të Drejtat e Njeriut dhe zgjidhjen e konflikteve

Ky doracak është pjesë e Projektit për integrim ndëretnik në arsim, i financuar nga populli amerikan përmes **Agjencisë së SHBA për zhvillim ndërkombëtar (USAID)**.

## Përmbajtja

<b>1. Hyrje</b>	
Për kë është i dedikuar doracaku?	3
Cilët mësimdhënës mund t'i realizojnë aktivitetet e përbashkëta ?	4
<b>2. Aktivitetet e përbashkëta me grupe nxënësish me përbërje të përziera etnike /gjuhësore si bazë për integrim ndëretnik në arsim</b>	
Cilat aktivitete të përbashkëta kontribuojnë për integrim ndëretnik?	5
Më çfarë qëllimi organizohen aktivitetet e përbashkëta?	6
Çka konsiderohet si aktivitet i përbashkët me grupin e përziera etnik/gjuhësor?	8
Si realizohen aktivitetet e përbashkëta në shkollat njëgjuhëshe?	9
Si bëhet përgatitja për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta me nxënësit?	10
<b>3. Drejtimit për shkollat dy/tregjuhëshe</b>	
3.1. Realizimi i aktiviteteve të përbashkëta afatshkurtëra	14
3.2. Realizimi i aktiviteteve të përbashkëta afatgjatë	20
3.3. Realizimi i aktiviteteve të përbashkëta mësimore	25
<b>4. Drejtimit për shkollat njëgjuhëshe</b>	
4.1. Realizimi i aktiviteteve të përbashkëta afatshkurtëra	32
4.2. Realizimi i aktiviteteve të përbashkëta afatshkurtëra	37
4.3. Realizimi i aktiviteteve të përbashkëta mësimore	41

**Doracakun e përgatitën:**  
**Filipina Negrievska, Violeta Petroska-Beshka dhe Safet Ballazhi**

*Ky doracak u mundësua me mbështetje të popullit zemërgjërë amerikan përmes Agjencionit të SHBA për zhvillimin ndërkombëtarë (USAID). Qëndrimet e autorëve të paraqitura në këtë doracak nuk i shprehin qëndrimet e USAIDose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.*

## 1. Hyrje

---

### Për kë është i dedikuar doracaku?

Doracaku është i dedikuar, parasegjithash për **mësimdhënësit** të cilët i realizojnë aktivitetet mësimore dhe jashtëmësimore me nxënësit në shkollat e fillore mirëpo pritjet që t'iu shërbejë edhe drejtorëve dhe shërbimit profesional të shkollave, të cilat janë të përfshira në planifikimin, organizimin dhe mbështetjen e këtyre lloj aktivitetesh. Në të janë të dhëna kahjet konkrete për atë se çka duhet të bëjnë të gjithë palët e përfshira në përgatitjen dhe realizimin e aktiviteteve të ndryshme mësimore dhe jashtëmësimore me grupe nxënësish të përziera etnike/gjuhësore.

Drejtimet për realizimin e e aktiviteteve të ndryshme mësimore dhe jashtëmësimore pothuajse janë identike për **shkollat fillore dhe të mesme**. Drejtimet për aktivitete që janë të përfshira në doracak, së pari janë të grupuara sipas asaj se vallë, kanë të bëjnë me shkolla me **dy/tre gjuhëhëshe ose një gjuhëhëshe**, e pastaj, në suaza të secilës nga këto dy kategori janë të ndara në aktivitete mësimore dhe jashtëmësimore. Me këtë rast është marrë parasysh se aktivitetet e përbashkëta shumë më thjeshtë mund të realizohen në shkollat me mësim në më tepër gjuhë dhe/ose në shkollat me përfaqsim të konsiderueshëm ( mbi 10%) nxënës të cilët janë pjestarë të bashkësisë së caktuar etnike e cila nuk ndjek mësimin në gjuhën e sajë amtare dhe/ose e ndjek në gjuhën e bashkësisë etnike shumicë në shkollë. Kjo ndonëse, nuk do të thotë se aktivitete të përbashkëta nuk janë të mundëshme edhe me nxënës të shkollave më homogjene etnike me mësim në një gjuhë. Doracaku jep drejtime të qarta edhe për atë se çka mund të bëhet në raste të tilla për të siguruar integrim ndëretnik në arsim.

Për ndjekje më të thjeshtë të drejtimeve, aktivitetet jashtëmësimore janë të ndara në afatshkurtëra dhe afatgjata. Si **afatshkurtëra** janë trajtuar ato aktivitete jashtëmësimore të cilat realizohen njëherë ( ose një herë gjatë vitit shkollor), siç është rasti me pikniqet, ekskursionet dhe vizitat, me shfaqjet dhe manifestimet, me zbavitjet maturanteske/ gjysëmaturanteske të nxënësve dhe me akcione të ndryshme, pa marrë parasysh se sa zgjat procesi i përgatitjes së përbashkët që u paraprin. Nga ana tjetër, si **më afatgjate** konsiderohen ato aktivitete jashtëmësimore të cilat realizohen në atë mënyrë që grupi i përbërë nga nxënës më përkatësi të ndryshme etnike/gjuhësore realizon një seri të të tërë takimesh ( së paku një herë ë javë) në një periudhë më të gjatë kohore, e cila nuk do të duhej të ishte më e shkurtë se një gjysëmjetor.

## **Cilët mësimdhënës mund t'i realizojnë aktivitetet e përbashkëta?**

Rol kyç në realizimin e aktiviteteve të përbashkëta me grupe nxënësish të përziera etnike/gjuhësore kanë mësimdhënësit. Nga motivimi i mësimdhënësve varet se vallë do të realizohen aktivitetet të cilat do të kontribuojnë për përmirësimin e integritetit ndëretnik në arsim.

Suksesi në realizimin e aktiviteteve të përbashkëta me nxënësit nuk varet nga ajo se cilën lëndë e ligjërojnë mësimdhënësit që janë përgjegjës për realizimin e aktivitetit. Duke u bazuar në atë se shumica e aktiviteteve të tilla nuk janë të lidhura me lëndë konkrete, ndërsa janë të orientuara kah zhvillimi social dhe personal i nxënësit, secili mësimdhënës mund të jetë realizator i sukseshëm i aktiviteteve të tilla nëse është i përgatitur t'i zhvillojë kompetencat e veta për punë të këtillë. Me fjalë tjera, se sa me sukses do të realizohen aktivitetet e tilla varet kryesisht nga kompetencat e mësimdhënësve, të cilët manifestohen në disa sfera të punës së tyre.

Mësimdhënës-realizatorë të suksesshëm të aktiviteteve të përbashkëta me nxënës janë ata të cilët i **respektojnë dallimet etnike** ndërmjet nxënësve dhe kolegëve, ata të cilët janë të vetëdijshëm për përkatësinë kulturore të tyre dhe të hapur **ndaj kulturave tjera dhe pjestarëve** të tyre. Kjo nuk do të thotë se mësimdhënësit e tillë nuk kanë paragjykime ndaj të tjerëve, por se ata janë të vetëdijshëm se i kanë ato dhe se janë të gatshëm të bisedojnë hapur për ngjajshmëritë dhe dallimet ndërmjet kulturave dhe në këtë mënyrë të zbulojnë prezencën e paragjykimeve tek vetvetja dhe tek nxënësit. Respektin e vet për kulturat tjera e shprehin përmes përmbajtjes nga vlerësimi ( miratimit ose mosmiratimit) të vlerave kulturore, zakoneve dhe paraktikave të tjerëve.

Realizatorë të suksesshëm janë ata mësimdhënës të cilët në mënyrë permanente përqipen **t'i kuptojnë mendimet dhe ndjenjat e të tjerëve** dhe ata që mund **t'i shqyrtojnë dhe ndjejnë çështjet nga perspektiva e të tjerëve**. Duke shfrytëzuar multiperspektivën si bazë për vështrimin e çështjeve, mësimdhënësit e tillë mund të krijojnë mjedis të sigurtë në të cilin nxënësit nuk frigohen t'i manifestojnë vlerat dhe nevojat e tyre kulturore, edhe atëherë kur janë të ndryshme nga vlerat dhe nevojat kulturore të tjerëve.

Mësimdhënësit të cilët janë realizatorë të mirë të aktiviteteve të përbashkëta me nxënësit kanë nivel të mjaftueshëm të **vetëbesimit** i cili u mundëson të **bashkëpunojnë me mësimdhënës të grupeve tjera etnike/gjuhësore** në kushte kur ai bashkëpunim nuk është praktikë e zakonshme dhe i dëshiruar. Gjatë kësaj, janë **të hapur të mësojnë për kulturën e të tjerëve** nga ata me të cilët bashkëpunojnë dhe bashkërisht me ta të ballafaqohen me të gjitha situatat të cilat janë rrezik potencial për bashkëpunimin e tyre reciprok dhe për aktivitetet me nxënësit.

## 2. Aktivitetet e përbashkëta me grupe të përziera etnike/gjuhësore si bazë për integrim ndëretnik në arsim

### Cilët aktivitete të përbashkëta kondribuojnë për integrim ndëretnik?

Aktivitetet e përbashkëta të cilat realizohen në grupe të përziera etnike/gjuhësore konsiderohen si segment shumë i rëndësishëm nga përpjekjet e përgjithshme për arritjen e integritimit ndëretnik si në arsim, ashtu edhe në përgjithsi në shoqëri. Qëllimi i arsimit të intergruar ndëretnik është që nxënësit nga grupet e ndryshme etnike/gjuhësore të mësohen në **interakcion**, i cili u është i nevojshëm për jetesë në Republikën e Maqedonisë si shoqëri multietnike. Që të arrihen kompetencat e nevojshme është e domosdoshme që nxënësit të marrin pjesë në aktivitete të përbashkëta të cilat janë të orientuara drejt zvogëlimi të **paragjykimeve** negative ekzistuese ndaj pjestarëve të etnikumeve të ndryshme, rritja e **bashkëpunimit** ndëretnik dhe krijimi i marrëdhënieve të **ndërvarësisë** kur bëhet fjalë për pjestarët bashkësive të ndryshme ndëretnike që jetojnë në Republikën e Maqedonisë.

Arsimi i integruar ndëretnik bazohet në sigurimin e sa është e mundur më shumë të aktiviteteve ndërmjet nxënësve që mësojnë të ndarë sipas gjuhës mësimore ( siç është rasti për shqiptarët dhe Maqedonasit ), ose në bazë tjetër ( siç është rasti më i shpeshtë me Romët). Gjithmonë kur nuk është e mundur të realizohen aktivitete të përbashkëta mësimore ( parasegjithash për shkak të gjuhës së ndryshme mësimore), duhet të organizohen aktivitete të përbashkëta jashtëmësimore. Duke u bazuar në atë se aktivitetet jashtëmësimore janë të orientuara kah zhvillimi personal social i nxënësve<sup>1</sup> është shumë me rëndësi që vazhdimisht të kihet parasysh se nuk është aq me rëndësi çka do të bëjnë nxënësit nga grupet e ndryshme etnike/gjuhësore por, të bëjnë diçka bashkërisht që është në interesin e tyre të përbashkët ( dhe kuptohet, që ajo të mos jetë në kundërshtim me interesat dhe nevojat e shkollës). Për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta është i rëndësishëm produkti i cili është i përcaktuar me qëllimin e përbashkët, po aq sa është i rëndësishëm interakcioni i drejtpërdrejtë në procesin e ardhjes së **produktit**. Në praktikë, kjo do të thotë se aktivitetet që realizohen në mënyrë paralele, në grupet etnike/gjuhësore të cilat e kalojnë **procesin** të ndarë, ndërsa takohen vetëm për ta prezantuar produktin, nuk mund të llogariten për aktivitete të cilat kondribuojnë për qëllimet e arsimit të integruar ndëretnik.

#### Çfarë aktiviteti multikulturorë kondribuon për integrimin ndëretnik?

Në shfaqje mund të futen pika multikulturore në mënyrë që kori i nxënësve të cilët mësojnë në gjuhën shqipe do të paraqitet duke kënduar këngë shqipe, ndërsa kori i përbërë nga nxënës që mësojnë në gjuhën maqedone do të paraqitet me këngë maqedone. Duke u nisur nga fakti se përgatitja e shfaqjes është zhvilluar në mënyrë paralele për të dy korët, paraqitja e tyre nuk kondribuon për integrim ndëretnik. Që të kondribuojë, të dy korët jo vetëm që duhet të paraqiten bashkërisht si një kor i cili do t'i ekzekutojë të dy këngët por duhet që të gjithë nxënësit ( nga dy gjuhët mësimore) bashkërisht të përgatiten për realizimin e të dy këngëve.

Aktivitetet e korit konsiderohen si integruese edhe atëherë kur në të marrin pjesë nxënës të dy gjuhëve mësimore dhe bashkërisht paraqiten me këngën në tjetër gjuhë ( e cila mund të mos ketë asnjë lidhje me kulturat e tyre), me kusht që tërë kohën bashkërisht të ishin përgatitur për shfaqjen.

1. Sipas Indikatorëve për kualitetin e punës së shkollave, Ministria e arsimit dhe shkencës në RM, 2011, fq.15

## Me çfarë qëllimi organizohen aktivitetet e përbashkëta?

Aktivitetet shkollorë dhe ato jashtëshkollorë në të cilat së bashku marrin pjesë nxënësit të cilët i përkasin grupeve të ndryshme etnike janë shumë të rëndësishme për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike të cilat janë të rënduara me stereotipe dhe paragjykimet. Përmes aktivitetëve të përbashkëta në grupe të përziera etnike, nxënësit mësojnë të komunikojnë njëri me tjetrin dhe në atë mënyrë të njihen me ngjajshmëritë dhe dallimet ndërmjet tyre, si në nivelin individual poashtu edhe në atë grupor. Aktivitetet e përbashkëta në grupe të përziera etnike e sigurojnë kontaktin e nevojshëm me të tjerët i cili e mundëson interakcionin dhe në kushte të caktuara, mund të kontribuojë për zvogëlimin e paragjykimëve negativë ndaj të tjerëve.<sup>2</sup>

Kontakti adekuat ndërmjet pjesarëve të grupeve të ndryshme etnike konsiderohet si njëra nga mënyrat më efektive të luftës kundër paragjykimëve. Nëse pjesarëve të një grupi të caktuar etnik u mundësohet të komunikojnë me të tjerët (pjesarë të grupit tjetër), do të krijohet mundësi që t'i kuptojnë dhe respektojnë pikpamjet e tyre, si dhe t'i njohin dhe respektojnë dallimet me nevojat dhe mënyrën e jetesës. Në këtë mënyrë do të zvogloheshin problemet që ekzistojnë ndërmjet pjesëtarëve të këtyre grupeve dhe do të përmirësohej interakcioni ndërmjet tyre.

Që kontakti intergrupor të jetë adekuat (të çojë drejt zvogëlimit të paragjykimëve për të tjerët dhe drejt rritjes së interakcionit me të tjerët), duhet të plotësohen kushtet vijuese:

- Të bazohet në ***bashkëpunim***;
- Të sigurojë status të ***barabartë***;
- Të udhëheqë drejt ***relacioneve interpersonale***, dhe
- Të ekzistojë ***mbështetje sociale dhe institucionale***.

**BASHKËPUNIM** Kur pjesëtarët e grupeve të ndryshme kanë qëllim të dëshiruar të përbashkët realizimi i së cilit varet nga bashkëpunimi ndërmjet tyre, është shumë e mundur se marrëdhëniet e tyre reciproke do të përmirësohen. Kjo do të thotë se është shumë me rëndësi që aktivitetet e përbashkëta me nxënës në grupe të përziera etnike të orientohen në drejtim të arritjes së qëllimeve konkrete (produkte që mund të preken), të cilat mund të realizohen vetëm nëse në realizimin e tyre marrin pjesë nxënës nga grupe të ndryshme etnike. Për shembull, të tilla janë: Dramatizime të përgatitura bashkërisht, gazetë e përbashkët shkollorë, ekspozitë e punimeve të përbashkëta, anketë e realizuar bashkërisht, etj.

Efektet nga interakcioni do të jenë më të mëdha nëse nxënësit nga grupe të ndryshme etnike bashkëpunojnë në realizimin e detyrave argëtuese interesante dhe tërheqëse të cilat do të jenë të realizuara me sukses dhe do t'u sjellin ndonjë mirënjohje (do t'u tregohet të tjerëve, ose do t'u sjellë ndonjë beneficion ose së paku ndonjë lëvërdi të vogël). Duhet patur kujdes që detyrat intergrupore të jenë të strukturuar ashtu që ata të prodhojnë interakcion pozitiv ndërmjet pjesëmarrësve të cilët janë pjesarë të grupeve të ndryshme etnike, që sigurohet përmes punës në atmosferë koperative e cila pamundëson rivalitet ndërmjet nxënësve të cilët i takojnë grupeve të ndryshme etnike. Nëse disa aktivitete nuk mund ta evitojnë këtë, atëherë gara duhet të orientohet ndërmjet grupeve të vogla të përziera (në suaza të tërë grupit të përzier) ose në ekipe (për shembull, sportive), të cilat janë me përbërje të përzier etnike. Përveç garave sportive ndërkollorë në të cilat marrin pjesë ekipe nxënësish me përbërje të përzier etnike, shembull tjetër për gara "të lejuara" janë kuizet dhe aktivitetet zbavitëse në të cilat garojnë ekipe të përziera etnike.

**STATUS I BARABARTË** Për të qenë efikas kontakti intergrupor, duhet të evitohen situatat e kontakteve në të cilat pjesëmarrësit e një grupi do të ndjehen, qoftë nga vetja qoftë nga të tjerët, si më pak të rëndësishëm nga pjesarët e grupit tjetër. Gajtë kësaj, duhet të merret parasysh nevoja për sigurimin e dy lloj statuseve të barabarta: njëri ka të bëjë me faktorët e jashtëm, siç është statusi socio-ekonomik i pjesarëve të cilët hyjnë

<sup>2</sup> Këtu dituritë e paraqitura shkencore në lidhje me ndikimin e kontaktit në zvogëlimin e paragjykimëve dalin nga kontakt hipoteza e psikologut social të njohur [Allport, G. E. (1954). *The nature of prejudice*. Reading, MA: Addison-Ëesley.], ndërkaq janë të vërtetuara në shumë hulumtime të realizuara në pesëdhjetë vitet e fundit nga një numër i madh autorësh në më shumë vende të botës.

në interakcion, ndërsa tjetri - statusi i brendshëm, i cili del nga tretmani i pjesmarrësve gjatë kohës së interakcionit. Kjo do të thotë se në rastin ideal, grupet e përziera etnike për aktivitete të përbashkëta duhet të jenë të balancuara në aspekt të statusit socio-ekonomik të pjesmarrësve të tyre ose në kuadër të secilit grup me variacione të njëjta në aspekt të këtij statusi. Përveç kësaj, aktivitetet e përbashkëta duhet të zhvillohen në kushte të cilat sigurojnë tretman të njëjtë të të gjithë pjesmarrësve në aktivitetin që manifestohet përmes përbërjes së balancuar të grupit të përzier ( gati numër të njëjtë të nxënësve nga etnikume/ gjuhë të ndryshme dhe nga të dy gjinitë), përmes përfaqsimit të njëjtë të gjuhëve të ndryshme mësimore në komunikimin gojor dhe me shkrim, në të gjitha materialet të cilat përdoren ose prodhojnë, si dhe me tretman të njëjtë të të gjithë nxënësve nga ana e mësimdhënësve që e drejtojnë aktivitetin, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike.

Në shkollat tona, sidomos kur bëhet fjalë për aktivitete të përbashkëta në grupe të përziera etnike të cilat përfshijnë nxënës Rom, nuk është gjithmonë lehtë të sigurohet status i barabartë socio-ekonomik. Kur kjo nuk është e mundur, sygjerohet të kihet kujdes që rolet të cilat u ndahen në grupe të jenë në nivelin e njëjtë statusor. Kështu për shembull, edhe nxënësit Romë ( por jo vetëm jo-Romët) ta prezantojnë punën në grupin e tyre të vogël ose të jenë përgjegjës për realizimin e diçkaje, duke patur kujdes që gjatë kësaj kërkesat ndaj të gjithëve të jenë mjaft të thjeshta që secili të mund t'i realizojë.

**REALACIONET INTERPERSONALE** Që të jetë efikas, kontakti intergrupor ndërmjet nxënësve nuk guxon të jetë sipërfaqësor, por ai duhet t'u ofrojë mundësi që ata të njihen në nivel individual( personal). Për këtë qëllim, është e domosdoshme që aktivitetet e përbashkëta të sigurojnë kontakte mjaftueshëm shpesh, mjaftueshëm gjatë dhe mjaftueshëm të afërta ndërmjet nxënësve që të mund të rriten në marrëdhënie reciproke të cilat kanë më shumë se rëndësi formale. Kështu për shembull, aktivitetet e përbashkëta në të cilat merr pjesë i njëjti grup i përzier etnik i nxënësve, të cilat realizohen më së paku një herë në javë (mjaftueshëm shpesh), gjatë tërë vitit shkollor ( mjaftueshëm gjatë), u mundëson pjesmarrësve të njihen në nivel individual dhe të shoqërohen edhe jashtë këtij aktiviteti të organizuar.

Kontakti duhet të realizohet në kushte të cilat krijojnë mundësi të interakcionit ndërmjet nxënësve nga intergrupor të rritet në kontakt interpersonal. Me fjalë tjera, në vend që gjatë interakcionit nxënësit të përjetojnë si pjestarë të grupeve etnike, të trajtohen njëri me tjetrin si individë, pavarësisht nga grupi etnik të cilit i takojnë. Kështu për shembull, Blerimi dhe Ivani deri sa bëjnë diçka bashkërisht, të komunikojnë ndërmjet veti vetëm si Blerim dhe Ivan, gjatë së cilit për ta aspak nuk është me rëndësi se njëri është Shqiptar, ndërsa tjetri Maqedonas.

**MBËSHTETJA SOCIALE DHE INSTITUCIONALE** Efektet nga kontakti ndaj marrëdhënies ndëretnike forcohen në kushte kur autoritetet në shoqëri e mbështesin interakcionin ndërmjet pjesëtarëve të grupeve të ndryshme etnike. Në kontekstin më të gjërë, në rolin e autoriteteve me ndikim mund të paraqiten politikanët dhe mediet. Nëqoftë se janë mbështetës të hapur të cilët e praktikojnë bashkëpunimin interetnik, prej tyre mund të pritët të ndikojnë ndaj kontaktit ndëretnik në të gjitha niveleve të jetës shoqërore.

Në kontekstin shkollor, në rolin e autoriteteve me ndikim mund të paraqiten struktura udhëheqëse, shërbimet profesionale, mësimdhënësit dhe prindërit, por vetëm me kusht që pjestarët e bashkësive të ndryshme etnike të cilat i përbëjnë këto struktura të angazhohen në mënyrë të barabartë për realizimin e kontaktit interetnik ndërmjet nxënësve. Gjatë kësaj, si më përgjegjës për krijimin e klimës për mbështetje konsiderohen kuadri udhëheqës dhe mësimdhënësit, prej të cilëve pritët që në mënyrë të hapur të angazhohen për politikën e pranimit dhe respektimit të dallimeve e cila do të jetë qartë e përfaqësuar në të gjitha dokumentet e shkollës.

## Çka konsiderohet si aktivitet i përbashkët me grupe të përziera etnike/gjuhësore të nxënësve?

Tabela 1. Kriteriumet për aktivitete të përbashkëta me grupe të përziera etnike/gjuhësore të nxënësve

<b>kriteriumi</b>	<b>përshkrimi i kriteriumit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• grupe pjesmarrëse të përziera etnike/gjuhësore</li> </ul>	Në aktivitet marrin pjesë nxënës nga së paku dy gjuhët e ndryshme mësimore ose së paku nga dy bashkësi etnike. Aktivitetin e realizojnë mesimdhënësit nga gjuha mësimore në të cilën mësojnë nxënësit të cilët janë pjesmarrës në aktivitet.
<ul style="list-style-type: none"> <li>• grupe pjesmarrës të balancuara sipas përkatësisë etnike, gjinore dhe moshës</li> </ul>	Pjesmarrësit në aktivitet janë grupe të balancuara sipas përkatësisë etnike, gjinore dhe moshës: (a) grupet janë pothuajse të barazuara për nga numri i nxënësve me përkatësi të ndryshme etnike ;(b) ka numër të barabartë të nxënësve nga të dy gjinitë në kuadër të secilit grup etnik, dhe (c) grupet formohen prej nxënësve të moshës së njëjtë ose përafërsisht të njëjtë.
<ul style="list-style-type: none"> <li>• interakcioni ndërmjet pjesmarrësve të grupeve të ndryshme etnike/gjuhësore</li> </ul>	Gjatë kohës së realizimit të aktivitetit nxënësit e njëres gjuhë mësimore /njërit grup etnik kontaktojnë me nxënës të gjuhës së tjetër / grupit tjetër etnik. Më i preferuar është kontakti i drejtpërdrejtë, me prezencë fizike në hapsirën ose vendin e njëjtë, i cili pjesërisht mund të zëvendësohet me komunikim elektronik audio/video.
<ul style="list-style-type: none"> <li>• përdorimi i të gjithë gjuhëve të përfaqsuara mësimore</li> </ul>	Gjatë realizimit të aktivitetit në mënyrë të barabartë janë të përfaqsuara të gjitha gjuhët mësimore në të cilat mësojnë nxënësit që marrin pjesë në aktivitet.
<ul style="list-style-type: none"> <li>• trajtim i barabartë i pjesmarrësve të të gjithë grupeve etnike/gjuhësore</li> </ul>	Mësimdhënësit që e realizojnë aktivitetin, i trajtojnë njëjtë nxënësit nga gjuhët e ndryshme mësimore/bashkësitë e ndryshme etnike. Me këtë rast, secili mësimdhënës ndjehet , nga ana e nxënësve të grupit tjetër etnik/gjuhësor, si i paanshëm në punën me ta në pjesën zyrtare dhe jozyrtare të aktivitetit ( në kujdesin që ua kushton dhe në mbështetjen që ua jep).
<ul style="list-style-type: none"> <li>• kontakte të personalizuara ndërmjet pjesmarrësve</li> </ul>	Aktiviteti realizohet ashtu që dërgon drejt sa më shumë që është e mundur kontakteve personale, të cilat arihen nëqoftë se sigurohen kontakte ndërmjet nxënësve të grupeve të ndryshme etnike/gjuhësore që janë mjaftueshëm të shpeshta dhe mjaftueshëm të gjata për tu rritur në marrëdhënie reciproke respektivisht në nivel personal.
<ul style="list-style-type: none"> <li>• arritja e qëllimeve konkrete me pjesmarrje të të gjithë bashkësive të përfaqsuara etnike</li> </ul>	Aktiviteti shkon drejt arritjes së qëllimeve konkrete në formë të produkteve të prekshme/të dukshme. Deri te kjo arrihet vetëm përmes pjesmarrjes së përbashkët të të gjithë bashkësive etnike/gjuhësore të përfaqsuara.
<ul style="list-style-type: none"> <li>• realizimi në atmosferë koperative</li> </ul>	Aktiviteti realizohet në atmosferë koperative e cila i inkurajon nxënësit e bashkësive të ndryshme etnike/gjuhësore. Kompetiviteti është i lejuar vetëm ndërmjet grupeve të ndryshme të cilat tanimë kanë formuar identitetin e përbashkët grupor, pavarësisht nga përkatësia etnike/gjuhësore e pjestarëve të tyre.
<ul style="list-style-type: none"> <li>• mbështetja nga komuna dhe prindët</li> </ul>	Përveç prej udhëheqësisë së shkollës, shërbimit profesional dhe mesimdhënësve, aktiviteti është haptazi i përkrahur edhe nga ana e prindërve dhe komunës.




Në kapitullin paraprak, përveç nevojës për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta me grupe nxënësish të përziera etnike/gjuhësore janë të parashtruara edhe strategjitë për realizimin e tyre në mënyrën e cila i bën maksimalisht efikas. Pikërisht nga arsyeshmëria e strategjive të parashtruara dalin kriteriumet të cilat duhet të përmbushen që aktiviteti i dhënë mësimor ose jashtëmësimor të llogaritet si aktivitet i përbashkët i nxënësve i cili kontribuon për integrim ndëretnik. Kriteriumet e tilla janë dhënë në Tabelën 1 në faqen paraprake. Tabela me kriteriume mund të shihet si çek listë e cila mund të shfrytëzohet për të provuar se vallë kriteriumet e caktuara janë respektuar gjatë planifikimit dhe realizimit të secilit aktivitet të përbashkët me grupin e nxënësve me përkatësi etnike/gjuhësore të përzier, pa marrë parasysh se a është aktiviteti mësimor ose jashtëmësimor.

Në fillim të realizimit të aktiviteteve mund të ndodhë që disa aktivitete të përbashkëta të mos i përmbushin të gjitha kriteriumet e theksuara në Tabelën 1. Kjo është e arsyeshmë vetëm nëqoftë se aktivitetet konsiderohen si hyrje, respektivisht si parapërgatitje për fazën e ardhëshme, në të cilën do të respektohen të gjitha kriteret e theksuara. Përgatitja e tillë mund të jetë e domosdoshme në shkollat të cilat kanë përvojë të vogël me aktivitete të përbashkëta nga ky lloj, dhe përvojën do ta arrijnë gjatë kohës realizimit.

### Si realizohen aktivitete të përbashkëta në shkolla njëgjuhëshe?


Që të mund të realizojë aktivitete të përbashkëta me grupe të përziera të nxënësve me gjuhë mësimore të ndryshme, një shkollë njëgjuhëshe duhet të formojë marrëdhënie partneriteti me një shkollë njëgjuhëshe me mësim në gjuhë tjetër. Mënyra e formimit të shkollave partnere është paraqitur në dy skemat vijuese të cilat e tregojnë në mënyrë të veçantë rastin e shkollave njëgjuhëshe nga komuna “njëgjuhëshe” dhe nga komuna “dy/tri gjuhëshe”. Në këtë doracak, që të thjeshtohet sqarimi për formimin e marrëdhënieve partnere, nën termin “njëgjuhëshe” nënkuptohet komuna në të cilën të gjitha shkollat fillore ose të mesme janë me mësim në gjuhë të njejtë. Duke u nisur nga kjo, si “dy/tregjuhëshe” trajtohen ato komuna në të cilat ka shkolla fillore ose të mesme me mësim në gjuhë të ndryshme. Gjatë kësaj, një komunë mund të jetë “dy/tregjuhëshe” në raport me përfaqsimin e gjuhëve të ndryshme mësimore në shkollat fillore, ndërsa, mund të jetë “njëgjuhëshe” kur bëhet fjalë për përfaqsimin e gjuhëve mësimore në shkollat e mesme.



Skema 1.

Skema 1 ( në anën e majtë ) i paraqet shkollat potenciale me të cilat mund të hyjë në marrëdhënie partneriteti një shkollë njëgjuhëshe e cila ndodhet në një komunë “dy/tre gjuhëshe”, me ç’rast opcionet e ofruara janë të radhitura sipas prioriteteve. Kështu, secila shkollë njëgjuhëshe nga komuna “shumëgjuhëshe” së pari kërkon partner ndërmjet shkollave njëgjuhëshe me gjuhë tjetër mësimore nga e njëjta komunë, nëqoftë se në komunë ka shkollë/a të tillë/a në

disponim. Nëse nuk mund të realizohet kjo, atëherë shkon në opcionin tjetër - kërkon shkollë “dy/tre gjuhëshe” me gjuhë tjetër mësimore dominante, gjatë së cilës dominante konsiderohet gjuha në të cilën mësojnë pjesa më e madhe e nxënësve në shkollë. Nëse ky opcion nuk është i realizueshëm, kërkon partner ndërmjet shkollave njëgjuhëshe me gjuhë tjetër mësimore nga komuna tjera.




Skema 2.

Në skemën 2 janë paraqitur partner shkollat potenciale për shkollat njëgjuhëshe nga komunat "një gjuhëshe", përsëri të radhitura sipas prioriteteve. Duke marrë parasysh atë se në komunat "njëgjuhëshe" të gjitha shkollat janë me mësim në gjuhë të njejtë, këto shkolla mund të formojnë marrëdhënie partneriteti vetëm me shkolla nga komuna tjera. Sipas prioriteteve, secila shkollë njëgjuhëshe nga komuna "njëgjuhëshe" së pari kërkon partner ndërmjet shkollave njëgjuhëshe me gjuhë tjetër mësimore, gjatë së cilës përparësi kanë ato nga komunat

"njëgjuhëshe", ndërkaq nëse kjo nuk është e realizueshme, atëherë në lojë hyjnë ato nga komunat dy/tregjuhëshe". Në fund, nëse janë shterur dy opcionet e përmendura, shkolla njëgjuhëshe nga komuna "njëgjuhëshe" kërkon partner në mesin e shkollave dy/tregjuhëshe me gjuhë tjetër dominante mësimore.

Në princip, në shumicën e shkollave dy/tregjuhëshe marrëdhëniet me një shkollë tjetër nuk e kanë të domosdoshme të realizojnë aktivitete të përbashkëta. Megjithatë, këto shkolla duhet t'u jenë mbështetje shkollave njëgjuhëshe gjithmonë kur ato nuk kanë zgjedhje tjetër, siç është e paraqitur në skemën 3 në anën e djathtë.



Skema 3.

Nga ana tjetër, marrëdhëniet e partneritetit mund të jenë shumë të dobishme për shkollat dy/trigjuhëshe me disbalancë të madhe ndërmjet gjuhëve mësimore. Numri jo i barabartë i nxënësve ( dhe i mësimdhënësve) në gjuhët e ndryshme mësimore në këto shkolla ua zvogëlon mundësitë për realizimin shumicës së aktiviteteve më afatgjate me respektimin e plotë të kriteriumeve të cilat sigurojnë arritje të suksesshme të efekteve. Nga ky shkak, marrëdhëniet partnere me shkollat njëgjuhëshe me mësim në gjuhën jo dominante mund të sigurojë balancin e nevojshëm dhe të mundësojë marrëdhënie më të barabarta ndërmjet nxënësve dhe mësimdhënësve nga gjuhë të ndryshme mësimore.

## Si bëhet përgatitja për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta me nxënësit?

Në mesin e faktorëve më të rëndësishëm prej të cilëve varet suksesi i aktiviteteve të përbashkëta është **zgjedhja e nxënësve**. Nxënësit mund të marrin pjesë në aktivitete të përbashkëta vetëm në baza vullnetare, për shkak se detyrimi mund të sjellë më shumë dëm se sa dobi. Duke marrë parasysh se në praktikën arsimore për nxënësit e bashkësive më të mëdha etnike është e zakonshme të jenë të ndarë sipas gjuhës mësimore, mund të pritët, sidomos gjatë inkuadrimit të aktiviteteve të përbashkëta, përgjigjja të jetë e vogël. Kjo nuk do të thotë se shkolla duhet të dorëzohet nga realizimi i aktiviteteve të përbashkëta, por se vetëm duhet të investojë angazhim shtesë që t'i tërheqë nxënësit për pjesëmarrje në aktivitete të tilla. Gjatë kësaj, mund të jetë plotësisht

e mjaftueshme që mësimitdhënësit t'i inkurajojnë nxënësit të cilët janë të perceptuar si liderë në mesin e nxënësve tjerë që të paraqiten për pjesëmarrje, me çka pastaj do ta "hapë derën" edhe për nxënësit tjerë të shkollës.

**Tabela 2. Plani akcional për aktivitet të përbashkët "Projekt hulumtues" për partner shkolla**

hapi konkret	Rezultat i pritur (produkti)	(para)kushtet	realizatorë	termini (prej/deri)
<b>zgjedhja e mësimitdhënësve</b>	zgjedhja e 1 mësimitdhënësi nga secila shkollë ( nga gjuhë të ndryshme mësimore)	<ul style="list-style-type: none"> <li>• takim me mësimitdhënësit potencial</li> <li>• kahje të shkruara për aktivitete të përbashkëta</li> </ul>	ekipet për integrim shkollor (ueb-faqet)	1.–5. nëntor.
<b>ndarja e hapsirës dhe paisjeve</b>	nga 1 hapsirë për shkollë me nga 3 kompjutorë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• lidhje e pandërprerë e internetit dhe video/audio (skype)</li> </ul>	ueb faqet me mësimitdhënësit e zgjedhur	10.–20. nëntor.
<b>zgjedhja e nxënësve</b>	nga 12 nxënës prej secilës gjuhë mësimore	<ul style="list-style-type: none"> <li>• kriteriumi për zgjedhje</li> <li>• ftesë për pjesëmarrje</li> <li>• paraqitje nga nxënës me rekomandime nga mësimitdhënësit</li> </ul>	mësimitdhënësit e zgjedhur	10.–20. nëntor.
<b>vendosja e kontaktit</b>	njohja në mes veti	<ul style="list-style-type: none"> <li>• video/audio lidhja e papenguar</li> </ul>	mësimitdhënësit e zgjedhur	1.–10. dhjetor.
<b>zgjedhja e temës së projektit</b>	përcaktimi i përbashkët i temës me marrëveshje (nga vetë nxënësit)	<ul style="list-style-type: none"> <li>• lista të veçanta të temave potenciale</li> <li>• video/audio lidhja</li> </ul>	mësimitdhënësit dhe nxënësit e zgjedhur	10.–20. dhjetor.
<b>planifikimi i realizimit</b>	plan i adaptuar për punë me detyra të definuara, afate dhe takime	<ul style="list-style-type: none"> <li>• tabela të caktuara akcionale për detyra të veçanta</li> <li>• video/audio lidhje</li> </ul>	mësimitdhënësit dhe nxënës e zgjedhur	1. shkurt. –30. prill.
<b>realizimi i projektit</b>	realizimi i së paku 6 takimeve të ndara (në kuadër të secilës shkollë) dhe 6 "takime të përbashkëta" ( me të gjithë nxënësit)	<ul style="list-style-type: none"> <li>• hapsira adekuate me kompjutorë dhe internet</li> <li>• video/audio lidhje</li> </ul>	mësimitdhënësit dhe nxënësit e zgjedhur	1.–15. maj
<b>prezentimi i projektit të përfunduar</b>	organizimi nga 1 ngjarje në çdo shkollë për prezentim të projektit para drejtorisë, kolegëve, bashkëpjesëm arrësit dhe i prindërve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• poster dhe materiale tjera që e prezantojnë procesin dhe produktin</li> <li>• ftesa për ngjarjen</li> <li>• hapësira dhe paisja</li> </ul>	mësimitdhënësit dhe nxënësit e zgjedhur	1.–5. nëntor.

Gjatë përgatitjeve për aktiviteteve të përbashkëta, mësimitdhënësit dhe persona të tjerë të përgjegjshëm në shkollë duhet të ndërmarrin edhe masa tjera për të siguruar realizim të suksesshëm të tyre dhe t'i paraevitojnë problemet që mund të fitojnë dimension interetnik. Kjo do të thotë se në shkollë duhet të ketë

**rregulla paraprakisht të miratuara** për sjelljen e nxënësve dhe mësimit të tyre kur bëhet fjalë për grupe të përziera etnike/gjuhësore që janë sjellur në rrugë demokratike, me argumentimin dhe koncenzusin e të gjitha palëve të përfshira. Njëkohësisht, edhe nxënësit dhe mësimit të tyre duhet të jenë të njohur edhe me pasojat paraprakisht të definuara nga forma të ndryshme të sjelljes që paraqesin mosrespektim të rregullave. Masat preventive përfshijnë edhe sigurimin e miratimit nga ana e nxënësve për pjesëmarrje në aktivitetin e përbashkët konkret, nga momenti kur do të jenë të njoftuar me programin e aktivitetit dhe me mënyrën e realizimit të tij.

Planifikimi efikas i aktiviteteve të përbashkëta me grupe nxënësish të përziera etnike/gjuhësore është parakusht plotësues për realizimin e suksesshëm të tyre. Në planifikim duhet të përfshihen edhe nxënësit nga të gjithë gjuhët e përfaqsuara mësimore që të forcohet jo vetëm pjesëmarrja e tyre në jetën e shkollës, por që të arihen edhe efekte më të mira nga realizimi i aktiviteteve të përbashkëta.

**Tabela 3. Plani aksional “project hulamtues”  
për shkolla dy/tri gjuhëshe**

Hap konkrete	Rezultat i pritur (produkt)	(para)kushte	realizatorë	Termin (prej/der i)
<b>zgjedhja e mësimit të mësimit</b>	zgjedhja e 1 mësimit nga secia gjuhë mësimore	<ul style="list-style-type: none"> <li>• takim me mësimit të potencial</li> <li>• kahe të shkruara për aktivitete të përbashkëta</li> </ul>	timi për integrim shkollor (ueb faqe)	1.–5. nëntor.
<b>ndarja e hapësirës dhe pajisjes</b>	1 hapësirë me 6-8 kompjuterë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• interneti lidhje e pandërprerë</li> </ul>	ueb faqe me mësimit të zgjedhur	10.–20. nëntor.
<b>zgjedhja e nxënësve</b>	nga 8/12 nxënës prej secilës gjuhë mësimore (grupe dy/tri gjuhëshe)	<ul style="list-style-type: none"> <li>• kriteriume për zgjedhje</li> <li>• thirrje për pjesëmarrje</li> <li>• paraqitje nga nxënësit me rekomandime të mësimit të mësimit</li> </ul>	mësimit të zgjedhur	10.–20. nëntor.
<b>zgjedhje e temës së projektit</b>	tema e dakorduar bashkërisht ( nga vet nxënësit)	<ul style="list-style-type: none"> <li>• takim i përbashkët</li> <li>• lista e përgatitur paraprakisht me më së paku 6 tema potenciale</li> </ul>	mësimit të zgjedhur	1.–10. dhjetor.
<b>planifikimi i realizimit</b>	plan i dakorduar për punë me detyra të definuara, afate dhe takime	<ul style="list-style-type: none"> <li>• takim i përbashkët</li> <li>• tabela aksionale për detyra të veçanta</li> </ul>	mësimit të zgjedhur	10.–20. dhjetor.
<b>realizimi i projektit</b>	të realizuara së paku 6 takime në grupe të përziera më të vogla dhe 6 takime “të përbashkëta” me tërë grupin	<ul style="list-style-type: none"> <li>• hapsira me kompjuterë me internet lidhje të pandërprerë</li> </ul>	mësimit të zgjedhur	1. shkurt. – 30. prill.
<b>prezentimi i projektit të përfunduar</b>	ngjarje e organizuar në shkollë për prezentimin e projektit para drejtorisë, kolegëve, bashkëpjesëmarrësve, nxënësve dhe prindërve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• poster dhe material tjera që e pasqyrojnë procesin dhe produktin</li> <li>• ftesa për ngjarjen</li> <li>• hapsira dhe pajisja</li> </ul>	mësimit të zgjedhur	1.–15. maj.

Me planifikimin e aktiviteteve të përbashkëta fillohet në nivel më global i cili e përfshin zgjedhjen e mësimdhënësve-realizatorëdhe zgjedhjen e nxënësve. Për secilin aktivitet të përbashkët plotësohet **tabelë akcionale** e veçantë, sipas modelit të shembujve të dhënë në tabelat 2 dhe 3. Nëse ndiqet modeli në shembujt e dhënë, plani akcional do të duhej të inkuadrojë disa elemente:

- **hapat** konkrete- krejt çka duhet ndërmarë që të realizohet aktiviteti i përbashkët i cili planifikohet;
- **rezultat i pritur (produkti)**– secili hap i përmendur përfundon me njëfarë rezultati ose produkti i cili është i prekshëm dhe i parë dhe lehtë mund të vërtetohet se a është i realizueshëm;
- **(para)kushte** – krejt çka duhet të realizohet që të mund të zbatohet hap ii përmendur dhe të arrihet deri te rezultati i pritur;
- **realizatorë**– personat nga të cilët pritet ta realizojnë hapin konkret, dhe
- **termin**– kornizë kohore në të cilën pritet të realizohet hapi konkret.

## 3. Drejtimet për shkollat dy/trigjuhëshe

### 3.1. Zbatimi i aktiviteteve të përbashkëta afatshkurtëra

#### EKSKURSIONET , PIKNIQET DHE VIZITAT

Të gjithë ekskursionet, pikniqet dhe vizita e shkollës në të cilën marrin pjesë më shumë se një paralele, duhet të jenë të përbashkëta – në to të marrin pjesë nxënës nga të gjitha gjuhët mësimore të cilët do t'i vizitojnë vendet e njëta në kohë të njëjtë.

#### Vendosja e rregullave për sjellje

Rregullat e sjelljes e rregullojnë mënyrën e komunikimit ndërmjet nxënësve, tregojnë se cila sjellje është e lejuar, e cila jo, dhe e theksojnë mënyrën e sanksionimit të sjelljes së palejueshme. Rregullat miratohen nëpërmjet procedurave demokratike dhe me konsensus të të gjithëve që marrin pjesë në sjelljen e tyre. Në këtë proces pritet :

- Mësimdhënësit nga të dy/tre gjuhëve të dakordojnë dhe të miratojnë rregulla të përbashkëta të sjelljes;
- Prindërit të marrin pjesë në miratimin e rregullave dhe të japin pëlqim me shkrim për rregullat e miratuara, dhe
- Nxënësit të njihen me rregullat para nisjes (nxënësit e shkollave të mesme të nënshkruhen se i pranojnë).

#### Zgjedhja e vendit/vendeve <sup>3</sup>

Mësimdhënësit nga dy/tre gjuhë mësimore bashkëpunojnë në përgatitjen e aktivitetit. Prej tyre pritet që bashkërisht të dakordohen për atë se ku do të realizohet ekskursioni dhe gjatë kësaj të zgjedhin vende të cilat janë me interes të përbashkët për nxënësit e secilës gjuhë mësimore. Në dakordim duhet të marrin pjesë prindërit ( përmes Këshillit të prindërve dhe me përbërje të përzier), ndërsa gjatë vendimarrjes duhet të merren parasysh propozimet nga nxënësit të dhëna nga organet e përbashkëta të nxënësve në shkollë, me respektimin e karakterit multikulturor të rajonit/vendit.

#### Përgatitja

Nga mësimdhënësit e dy/tre gjuhëve mësimore pritet të punojnë në formë ekipore me qëllim:

- të sigurojnë përkthim të sqarimeve zyrtare të vendeve të vizituara, pyetjeve dhe përgjigjeve;
- nëse kërkojnë nga nxënësit të prezantojnë para, gjatë kohës së vizitës ose pas saj, përgatitjen ta bëjnë edhe për bashkësinë/të tjetër/ra etnike, e jo vetëm për të vetën, dhe
- të japin rezume të përbashkët të vizitës dhe të tregojnë ku mund të gjenden materialet plotësuese në dy/tre gjuhë.

#### Organizimi i udhëtimit dhe i qëndrimit

Mësimdhënësit përgjegjës të dy/tre gjuhëve mësimore bashkëpunojnë në përgatitjen e aktivitetit.

Prej tyre, si ekip, pritet:

„Ekskursionet për të gjithë nxënësit nga e njëjta klasë në shkollë organizohen dhe realizohen njëkohësisht, me përmbajtje dhe aktivitet të njëjtë.”

(Nga Rregullorja për mënyrën e realizimit të ekskursioneve dhe aktiviteteve tjera të lira të nxënësve të shkollave fillore, Neni.12)

„Në planifikimin e ekskursioneve duhet t'i kushtohet rëndësi rolit më të madh prindërve të nxënësve dhe të kihet kujdes që të gjithë fëmijët të përfshihen në to pa marrë parasysh statusin e tyre social.”

(Nga konferenca për edukim dhe arsim fillor nënëtvjeçar, 2007, fq.112)

<sup>3</sup> Nga nëntori i vitit 2010 në fuqi është Rregullore e çantë për mënyrën e realizimit të ekskursioneve të nxënësve dhe të aktiviteteve tjera të lira për nxënës të shkollave fillore

- të dakordohen dhe të miratojnë rregulla të përbashkëta të sjelljes, dhe
- në autobus të lëshojnë muzikë të huaj, ose në mënyrë reciproke nga një këngë prej të gjitha gjuhëve mësimore që përfaqsohen në shkollë.

Nga nxënësit pritet:

- gjithmonë kur është e mundëshme, të udhëtojnë me të njëjtin autobus duke u grupuar sipas moshës ( për shembull, një klasë e dytë me gjuhë mësimore maqedonase dhe një me gjuhë mësimore shqipe/turke), dhe
- të vendosen ( gjatë qëndrimit në hotel/pushimore) në dhoma sipas klasave, e jo në pjesë të ndryshme të hotelit ose në ndërtesa të ndryshme, të ndarë në bazë të gjuhës mësimore.

Këshilli i prindërve me përbërje të përzier etnike bashkëpunon në përgatitjen e aktivitetit. Prej tyre, si ekip, pritet:

- të merr pjesë në miratimin e rregullave të sjelljes dhe të kërkojë nga të gjithë prindërit të japin pëlqim me shkrim për rregullat e miratuara;
- të kërkojë nga prindër me përkatësi të ndryshme etnike/gjuhësore të paraqiten vullnetarisht për pjesëmarrje në ekskursion si ndihmës të mësimdhënësve, dhe
- ta vlerësojë përshtatshmërinë e ekskursionit për nxënësit e grupeve të ndryshme etnike dhe të kërkojë mënyrë për të siguruar kushte që të gjithë fëmijët, pa marrë parasysh statusin ekonomik të tyre të marrin pjesë në ekskursion, piknik ose vizitë.

### **Organizimi i ushqimit**

Nga mësimdhënësit përgjegjës nga dy/tre gjuhët mësimore pritet që paraprakisht të sigurojnë ushqim që shërbehet për t'i kënaqur preferencat dietale të nxënësve nga kulturat e ndryshme dhe nga restorantet të kërkojnë që të ofrohet ose ushqim i njëjtë për të gjithë, ose të ketë zgjedhje nga dy ushqime për të gjithë (përfshi edhe ushqimin vegetarian).

### **Mbrëmjet shoqërore/zbavitjet**

Nga mësimdhënësit prej dy/tre gjuhëve mësimore pritet të punojnë në formë ekipore me qëllim që të sigurojnë që muzika t'i plotësojë preferencat e nxënësve nga grupet e ndryshme etnike/gjuhësore. Që të evitohet lëshimi i muzikës të cilën nxënësit e kanë me vete, dhe e cila mund të jetë me përmbajtje ofenduese dhe nënçmuese për ndonjërin prej bashkësive etnike, mundet paraprakisht antarët e organit të nxënësve të emruar si përgjegjës për organizimin e ekskursioneve, piknikeve dhe vizitave, së bashku me dy/tre mësimdhënës të gjuhëve të ndryshme mësimore, të bëjnë zgjedhje të muzikës dhe ate ta lëshojnë. Me këtë rast mund të lëshohet muzikë e huaj, dhe/ose në mënyrë reciproke të lëshohet muzikë në dy/tre gjuhë të përfaqsuara mësimore.

### **Koha e lirë**

Mësimdhënësit përgjegjës nga të dy/tre gjuhëve mësimore bashkëpunojnë në përgatitjen e aktivitetit. Prej tyre, si ekip, pritet:

- ta strukturojnë kohën e lirë dhe të ofrojnë aktivitete për nxënësit në përbërje të përzier etnike në të cilat marrin pjesë edhe vetë mësimdhënësit;
- nëse ekskursioni/pikniku/vizita realizohet në natyrë ( në vend të hapur ), duhet të organizojnë aktivitete sportive/rekreative me nxënës të cilët formojnë ekipe të përbashkëta etnikisht të përziera të cilat garojnë në mes veti; aktivitetet e tilla nuk është e domosdoshme të kenë karakter garues, por ato mund të jenë lojëra për bashkëpunim të nxënësve ( nxënësit nga organet përkatës të nxënësve së bashku me mësimdhënësit e arsimit fizik mundën paraprakisht të bëjnë zgjedhje të aktiviteteve të tilla dhe t'i ofrojnë gjatë kohës së ekskursionit;
- gjatë organizimit eventual të maskenballit të kenë kujdes që asnjë nga maskat të mos jetë nënçmuese ose ofenduese për cilindo grup etnik.

- të mos rekomandohet që nxënësit me përbërje të përzier etnike të shkojnë në mënyrë të pavarur në diskotekë ose kafene ku ka edhe misafirë tjerë për shkak të rrezikut të hedhjes së fjalëve dhe provokimeve dhe
- të mos lejojnë vizita nga persona të jashtëm ( farefis ose miq të nxënësve/ mësimdhënësve që të mos e prishin dinamikën e grupës.

### GOSTIA NË SHKOLLË

Është mirë që shkolla të inkurajojë gostinë e personave nga përkatësia e ndryshme etnike. Gjatë kësaj të kujdeset për sa vijon:

në shkollë të ftohen për gosti persona nga bashkësia me përkatësi etnikë

të ndryshme, por në numër të balancuar, sidomos kur bëhet fjalë për pjestarë të grupeve të ndryshme gjuhësore të përfaqsuara në shkollë;

- në shkollë të ftohen për gosti, grupe të nxënësve dhe mësimdhënësve nga shkolla tjera me përkatësi të ndryshme etnike;
- për çdo fjalim të misafirëve para ndonji grupi, shkolla të sigurojë përkthim në të gjitha gjuhët mësimore, dhe
- publikun gjithmonë ta përbëjnë nxënës nga të gjitha gjuhët mësimore të përfaqsuara në shkollë, pavarësisht nga përkatësia etnike/gjuhësore të misafirëve.

Në shkolla me përfaqsim të konsiderueshëm të nxënësve Rom, ftohen për gosti personalitete të dalluar të bashkësisë rome dhe gjatë kësaj duhet të kihet kujdes që përveç nxënësve Rom, të ketë edhe nxënës që nuk janë Rom.

### SHFAQJE DHE MANIFESTIME

Pritet që në të gjitha shfaqjet dhe manifestimet në shkollë të marrin pjesë nxënës nga të gjitha gjuhët e përfaqsuara mësimore me pika të përziera gjuhësore, pa marrë parasysh në ate se organizohen për ndonjë rast të përbashkët ose për nder të ndonjë festës/ ngjarjes që

është e rëndësishme për identitetin e pjestarëve të bashkësisë së caktuar etnike/gjuhësore të përfaqsuar në shkollë.

„Është e nevojshme që shkolla të përgatitë programe dhe të organizojë aktivitete për shënimin e manifestimeve të rëndësishme ( festa e shkollës, festat shtetërore, dhe në veçanti manifestimet për shënimin e fillimit dhe mbarimit të vitit shkollor etj.). Këto aktivitete detyrimisht planifikohen që nxënësit të mund t'i prezantojnë rezultatet para prindërve dhe banorëve tjerë në mjedisin lokal dhe më gjërë. Përmes këtyre aktiviteteve shkolla i paraqet të ariturat në mësim edhe në aktivitetet e lira të nxënësve (kor, orkestër, grupe të dramës dhe grupe letrare, krijimtari vizatimore etj.)”

(Nga Koncepti për arsim fillor nëntëvjeçar, shkurt.2007., fq.113)

### Përgatitja

Mësimdhënësit përgjegjës nga dy/tre gjuhë mësimore bashkëpunojnë në përgatitjen e aktivitetit. Prej tyre, si ekip, pritët që:

- gjatë hartimit të programit të kenë kujdes që ai të reflektojë karakterin multikulturor/ multigjuhësor të shkollës si në raport me përmbajtjet, ashtu edhe në raport me pjesëmarrësit;
- të zgjedhin pika të cilat nuk janë të gjata për shkak se shfaqja duhet të ketë kohëzgjatje të zakonshme, ndonëse respektimi i principit për përfaqsim të barabartë të gjuhëve e zgjat ate;

- të sigurojnë që në të gjitha pikat bashkërisht të marrin pjesë nxënës që ndjekin mësimin në gjuhë të ndryshme mësimore dhe/ose i takojnë grupeve të ndryshme etnike pa marrë parasysh nëse përmbajtja/gjuha ka të bëjë vetëm me një grup etnik ( për shembull, kori i cili duhet të formohet prej nxënësve me përkatësi të ndryshme etnike, në mënyrë reciproke këndon një këngë të njëjës gjuhë mësimore ndërsa tjetri grup, në gjuhë mësimore të dytë/tretë , ose seksioni i valltarëve i cili duhet të jetë i formuar me nxënës me përbërje të përzier, në mënyrë reciproke luan një valle që është karakteristike për njëjërën, pastaj për grupin tjetër etnik);



- të sigurojnë që në ato pika të cilat janë me dramatizim të jenë të përfaqsuara të gjitha gjuhët, gjatë së cilës kur një nxënës flet në një gjuhë mësimore, ai që do të ndërlihet në gjuhën tjetër së pari rezimon çka është thënë paraprakisht, dhe pastaj vazhdon me diçka të re në atë gjuhë;
- të sigurojnë që në ato pika të cilat janë me recitime në më shumë gjuhë në mënyrë reciproke të marrin pjesë nxënës nga gjuhë të ndryshme mësimore, me ç'rast është e dëshirueshme që secili nxënës të angazhohet së paku pjesërisht të recitojë edhe në gjuhën në të cilën nuk e ndjek mësimin;
- të sigurojnë që në pikat në të cilat nxënësit prezantojnë krijime personale, secili të flasë në gjuhën në të cilën e ndjek mësimin, ndërsa përkthimi i tekstit të paraqitet në video bim në prapavijë, në vend se të përkthehet; nëse përkthehet, ekziston rreziku që aktiviteti të stërzgjetet, të bëhet i mërziqshëm dhe të stimulojë dëgjim të kujdesshëm vetëm kur bisedohet në njërin gjuhë, ndërsa kur flitet në gjuhën e dytë/tretë të shfaqen biseda të ndërmjetëshme në publik, zhurmë dhe jo vëmendje;
- në aktivitete ku ka prezetim të produkteve, të sigurojnë së paku nga dy/tre nxënës – nga një prej secilës gjuhë mësimore/grup etnik të jenë të angazhuar të japin informata dhe të përgjigjen në pyetjet e vizitorëve;
- gjatë manifestimeve dhe shënimeve të ditëve/ngjarjeve të rëndësishme kryesisht për njërin bashkësi etnike ( dita e Flamurit Shqiptarë, Shën Kirili dhe Metodi, etj.) të sigurojnë pjesëmarrje të nxënësve dhe prezencë të vizitorëve nga të gjitha bashkësitë etnike të përfaqsuara në shkollë dhe gjatë kësaj nxënësit të cilët marrin pjesë në grupe të përziera ( kor, seksionin e valltarëve...) prezantohen në gjuhën e grupit me të cilin ka të bëjë manifestimi ( balancimi i gjuhëve arrihet me ate që në shfaqjen e cila është karakteristike vetëm për grupin tjetër etnik/gjuhësor, do të prezantohet në gjuhën e atij grupi);
- Grupe nxënësish nga grupe të ndryshme gjuhësore/etnike të marrin pjesë në shfaqje me theks të ngjajshmërive në mes festës së njëres bashkësi kulturore/etnike dhe pandanin e tyre në grupin etnik/kulturor të tyre dhe
- Gjatë përgatitjes së kalendarit të manifestimeve dhe shfaqjeve në shkollë, të kujdesen që të ketë raste të cilat janë mbi, respektivisht jasht festave të grupeve të veçanta etnike në shkollë, që do të thotë festa të cilat janë të një rëndësie të njëjtë për të gjithë nxënësit në shkollë dhe nuk kanë konotacion etnik/kulturorë/religjioz ( si për shembull, fillimi/përfundimi i vitit shkollor, Dita e fëmijës, Dita e pranverës...).

Në shkolla ku përfaqsimi i nxënësve është i konsiderueshëm, gjatë përpilimit të programit duhet patur kujdes që të vendosen pika të cilat kanë të bëjnë me bashkësinë rome në madhësi dhe kualitet të barabartë sikurse edhe për bashkësitë tjera etnike. Në një pjesë të pikave mund të jetë e përfaqshuar edhe gjuha rome, nëse e flasin nxënësit Rom në shkollë.

### Misafirë

Kur ftohen misafirë nga bashkësia për ndonjë shfaqje ose manifestim, mësimdhënësit duhet të kujdesen që:

- ata të jenë persona që janë të rëndësishëm për grupet e ndryshme etnike dhe paraprakisht të parashohin se ku do të ulen që të mos ketë grupim në bazë etnike/gjuhësore, dhe
- ftesat që ua dërgojnë të jenë të përgatitura në dy/tri gjuhë në një listë ose në të njëjtën ftesë elektronike, pa marrë parasysh përkatësisë etnike të misafirit të ftuar.

### Realizimi

Mësimdhënësit përgjegjës nga dy/tre gjuhët mësimore bashkëpunojnë në përgatitjen e aktivitetit. Prej tyre, si ekip, pritët:

- të gjithë paralajmërimet e pikave të zhvillohen në të gjitha gjuhët mësimore të përfaqsuara në shkollë;
- pikat e gjuhëve të ndryshme të realizohen në mënyrë reciproke, e jo të ndara në bloqe njëgjuhëshe.
- të ketë afërsisht numër të barabartë të pikave të gjuhëve të ndryshme mësimore të përfaqsuara në shkollë, respektivisht numër të barabartë të pikave që kanë të bëjnë me pjesëtarët e kulturave të ndryshme prezente në shkollë;
- i tërë materiali tekstual-vizuel dhe/ose shenjat për ngjarjen të

Në shkollat fillore me shumë nxënës ( dhe shumë paralele), rekomandohet të organizohen shfaqje të ndara: shfaqje e veçantë për nxënës nga mësimi klasor, dhe shfaqje e veçantë për nxënësit nga mësimi lëndor. Kështu do të mund të sigurohet pjesëmarrje e një numri më të madh të nxënësve në program, pa u reflektuar në kohëzgjatjen e shfaqjes.

jenë të përgatitura në të gjitha gjuhët mësimore të përfaqsuara, me madhësi dhe formë të njëjtë të shkronjave gjatë së cilës duhet patur kujdes të ndryshohet radhitja e gjuhëve;

- në shfaqje/manifestim të marrin pjesë sa është e mundur numër më i madh i nxënësve nga të gjitha grupet etnike/gjuhësore, sipas afiniteteve dhe dëshirave të tyre, gjatë së cilës duhet të evitohet pjesmarrja e nxënësve të njëjtë në të gjitha shfaqjet/manifestimet;
- të ketë pika/ngjarje përmes së cilave do të sigurohet pamja në aktivitetet multikulturore që realizohen në shkollë;
- nëse ndahen mirënjohje/diploma/certifikata për nxënësit, ato duhet të jenë të shkruara në të gjitha gjuhët mësimore të përfaqsuara, me përjashtim të emrit të nxënësit, i cili shkruhet në gjuhën dhe shkrimin të cilën e ndjek mësimin nxënësi.

### ZBAVITJET MATURANTESKE / GJYSËMATURANTESKE

Zbavitjet e maturës, respektivisht gjysëmaturës dhe zbavitjet tjera të organizuara dhe/ose të mbështetura nga ana e shkollës duhet të jenë të përbashkëta – të ndodhin në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend për nxënësit e të gjitha gjuhëve mësimore të përfaqsuara.

### Zgjedhja e vendit

Nga organet e përbashkëta të nxënësve pritet të japin propozime për vende ku do të mund të organizohen zbavitjet maturanteske/gjysëmaturanteske dhe gjatë së cilave duhet patur kujdes që qyteti/lokali të jenë në mjedis të përzier etnik në të cilën nuk është e parëndomtë ose e papranueshme të ndodhin aktivitete me persona të përbërjes së përzier etnike, respektivisht të jëtë e perceptuar si vend në të cilën komd ndjehen nxënësit nga të dy/tre grupet e ndryshme etnike. Propozimet e tyre shqyrtohen nga ana e ekipit të përzier etnik/gjuhësorë të mësimdhënësve, përgjegjës për zbatimin e këtyre lloj argëtimit dhe në mënyrë serioze ato të merren parasysh gjatë vendimarrjes ku do të zhvillohet zbavitja.

Në shkolla me përfaqsim të konsiderueshëm të nxënësve Rom, gjatë organizimit të zbavitjeve maturanteske/gjysëmaturanteske duhet patur kujdes të veçantë që qyteti/lokali të jetë mjedis në të cilin do të ndjehen komod edhe nxënësit Rom. Përfaqses të bashkësisë rome në organet e nxënësve dhe në Këshillin e prindërve duhet të jenë të konsultuar për ate dhe për menynë e restorantit dhe repertoarin muzikor të zbavitjes.

### Përgatitja

Mësimdhënësit përgjegjës nga të gjitha gjuhët e përfaqsuara mësimore bashkëpunojnë në përgatitjen e aktivitetit. Prej tyre, si tim, pritet:

- bashkë me organin e përbashkët të nxënësve i caktuar si përgjegjës për organizimin e zbavitjeve të tilla dhe së bashku me prindërit e Këshillit të prindërve t'i dakordojnë rregullat për sjellje të nxënësve gjatë kohës së zbavitjes dhe t'i përgatisin në formë të shkruar.
- të mbajnë mbledhje prindore në të cilat do t'i njohin prindërit me organizimin e zbavitjes maturanteske/gjysëmaturanteske dhe të bëjnë biseda të përgatitura me nxënësit nga të gjithë paralelet për të cilat është dedikuar zbavitja, dhe
- paraprakisht të sigurojnë ushqim që shërbehet t'i kënaq preferencat dietale të nxënësve nga kultura të ndryshme dhe të kërkojnë nga restoranti të ofrohet ose ushqim i njëjtë për të gjithë, ose të ofrojë zgjedhje prej dy ushqimeve për të gjithë ( përfshirë edhe ushqim vegjetarian).

Nxënësit nga organi i përbashkët i nxënësve i caktuar si përgjegjës për organizimin e zbavitjeve të këtitlla bashkëpunojnë në përgatitjen e aktivitetit. Prej tyre, pritet që:

- bashkërisht me mësimdhënësit përgjegjës dhe me prindërit e Këshillit t'i dakordojnë rregullat e sjelljes së nxënësve gjatë kohës së zbavitjes dhe t'i përgatisin në formë të shkruar, në më shumë gjuhë ( në të gjitha gjuhët mësimore të përfaqësuara në shkollë);
- t'i bëjnë rregullat në formë të shkruar, transparente për të gjithë nxënësit për të cilët është e dedikuar zbavitja ( të vendosura në vende të theksuara dhe të shpërndara në formë të formularit për pëlqim me shkrim);

- të kërkojnë që të gjithë nxënësit-pjesmarrës në zbatim të dorëzojnë pëlqim me shkrim për rregullat e sjelljes të nënshkruara nga prindërit/kujdestarët e tyre ( nxënësit madhorë vetë nënshkruhen në pëlqimin me shkrim);
- të zgjedhin/miratojnë muzikën që do të lëshohet në zbatim, me ç'rast muzika duhet të jetë ose e huaj, ose të jetë e kombinuar nga muzika e huaj dhe vendore me përfaqsim të barabartë të këngëve karakteristike për grupet etnike të ndryshme të nxënësve në shkollën përkatëse.

Këshilli i prindërve me përbërje të përzier etnike bashkëpunon në përgatitjen e aktivitetit. Prej tyre, si ekip, pritet:

- të marrë pjesë në miratimin e rregullave për sjellje, dhe
- të kërkojë nga të gjithë prindërit të japin pëlqim me shkrim për rregullat e miratuara.

### Realizimi

- gjatë zbatimit të pranishmit nga të gjitha gjuhët mësimore të qëndrojnë së bashku në të njejtën tavolinë, ose së bashku ( në përbërje të përzier etnike) të shpërndarë në më shumë tavolina;
- mësimdhënësit e pranishëm t'u ofrohen të gjithë nxënësve në mënyrë të barabartë, pa marrë parasysh në cilën gjuhë e realizojnë mësimin dhe në mënyrë konsekuente të kujdesen për respektimin e rregullave nga ana e të gjithë nxënësve, dhe
- mësimdhënësit nga të gjitha gjuhët mësimore duhet të jenë prezent në hapsirat në të cilat zhvillohet zbatimja deri në përfundimin e saj.

„Puna e dobishme humanitare e nxënësve më së shpeshti realizohet në mjedisin lokal. Për këtë qëllim përgatiten programe për mbrojtjen dhe ruajtjen e natyrës dhe rrethinës, akcione punuese të nxënësve, organizohen grupe nxënësish dhe asociacione me qëllime dhe përmbajtje të llojllojshme për punë që e udhëheqin nxënësit.”

(Nga Koncepti për arsim dhe edukim fillor nëntëvjeçar, shkurt.2007., fq.111)

### **AKCIONE EKOLOGJIKE**

Të gjithë akcionet ekologjike në të cilët marrin pjesë nxënës nga shkolla duhet të jenë të përbashkëta – të realizohen me grupe nxënësish të përziera etnike/gjuhësore të koordinuar nga ana e ekipit të mësimdhënësve të përzier etnik/gjuhësor.

Nxënësit dhe mësimdhënësit nga të dy/tre gjuhëve mësimore bashkëpunojnë në përgatitjen dhe realizimin e të gjithë akcioneve ekologjike brenda dhe jashtë shkollës. Prej tyre, si ekip, pritet si më poshtë:

- nëse akcioni përbëhet nga më shumë aktivitete të ndryshme, nxënësit të punojnë në grupe të vogla në përbërje të përzier etnike/gjuhësore;
- në akcionet për pastrimin e shkollës gjithmonë të sigurohet pjesmarrje e nxënësve nga të gjithë gjuhët mësimore të cilët bashkërisht i pastrojnë të gjitha hapsirat e caktuara, pavarsisht nëse ju shërbejnë më shumë nxënësve/mësimdhënësve nga njëra apo tjetra gjuhë mësimore;
- të gjitha slloganet, plakatat, transparentet të përgatiten në të gjitha gjuhët mësimore në shkollë, sidomos duke patur kujdes në përfaqsimin e barabartë të gjuhëve;
- raportet për aktivitetet të theksohen të shkruara në të dy/tre gjuhët mësimore.

~~~~~  
 Në shkollat me përfaqsim të  
 konsiderueshëm të nxënësve  
 Rom, në akcionet e përbashkëta  
 ekologjike në veçanti i kushtohet  
 kujdes që të gjitha aktivitetet  
 teknike ndihmëse të jenë të  
 përfaqsuara në mënyrë të  
 barabartë ndërmjet nxënësve, dhe  
 dhe jo t'u delegohen nxënësve  
 Rom.  
 ~~~~~

### **NGJARJET NË BASHKËSI**

Nxënësit e shkollës duhet të jenë të inkurajuar të marrin pjesë në ngjarje nga më të ndryshmet të cilat organizohen në bashkësinë, siç janë për shembull: manifestimi i Ditës së komunës, pjesmarrja në ekspozita afariste humanitare dhe hepeningje, pjesmarrja në debate dhe tribuna, pjesmarrja në kampanja për ngritjen e vëditjes publike për probleme të

ndryshme sociale etj. Secili angazhim i tillë i nxënësve duhet të jetë i përbashkët – të realizohet nga grupi i nxënësve – përfaqësues të shkollës, me përbërje të përzier etnik/gjuhësor.

Mësimdhënësit përgjegjës marrin pjesë në përgatitjen dhe realizimin e ngjarjeve në bashkësi. Prej tyre, si ekip, pritet:

- t'i shqyrtojnë të gjitha ftesat për përfshirjen e shkollës në ngjarje për bashkësinë dhe mbi bazën e vlerësimit të realizuar në raport me atë se sa mundësojnë promovim të multikulturës, t'i informojnë nxënësit dhe mësimdhënësit;
- të sigurojnë që në të gjitha ngjarjet në bashkësi në të cilën është e përfshirë shkolla bashkërisht të marrin pjesë nxënësit dhe mësimdhënësit nga të gjithë gjuhët mësimore të përfaqësuara në shkollë, respektivisht të pamundësojnë shkolla të jetë e përfshirë në ngjarje që zhvillohen në bashkësi në të cilat do të përfaqsohet ose prezentohet nga ana e përfaqësuesëve nga njëri grup etnik/gjuhësor;
- në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me shkollat tjera të inkurajojnë dhe inicojnë ngjarje të ndryshme për bashkësinë përmes së cilave nxënësve dhe mësimdhënësve do t'u mundësojnë në mënyrë aktive të participojnë në bashkësinë, duke demonstruar modelin e jetës multikulturore/multi-etnike;
- për të gjithë ngjarjet për bashkësinë të vendosin lajmërim në tabelën e shpalljeve në të dy/tre gjuhët mësimore, dhe
- raportet nga aktivitetet të vendosen të shkruara në të dy/tre gjuhët mësimore;

Nga nxënësit anëtarë në organin përkatës të nxënësve me përfaqësues nga të gjitha grupet e përfaqësuara etnike/gjuhësore mund të pritet:

- të marrin pjesë në përgatitjen e programit për prezantim të shkollës në ngjarjet që zhvillohen në bashkësi me propozime dhe sygjerrime të tyre, dhe
- të mos pranojnë të marrin pjesë në ngjarjet në bashkësinë të cilat nuk e promovojnë dhe prezentojnë shkollën si mjedis multikulturore/multi-etnik.

### 3.2. Realizimi i aktiviteteve të përbashkëta afatgjata

„Program i shkollës përfshin ngjarje të ndryshme jashtëmësimore të nxënësve për të plotësuar interesat individuale dhe zhvillimin e aftësive të nxënësve për punë të përbashkët e cila kontribuon për përfundimin e besimit të ndërsjellë, shoqërimin në kohën e lirë dhe ngajshëm me te.”

(Nga Koncepti për edukim dhe arsim fillor nëntëvjeçar, shkurt. viti 2007., fq. 109)

Puntoritë multikulturore janë një sërë aktivitete multikulturore jashtëmësimore të cilat zhvillohen në formë të seksioneve me nxënës dhe mësimdhënës në përbërje të përziera etnike/gjuhësore. Këto puntori i

#### PUNËTORI MULTIKULTURORE

udhëheqin nga **dy mësimdhënës** nga gjuhë të ndryshme mësimore dhe në to, sipas dëshirës së tyre marrin pjesë numër **i ballancuar i nxënësve nga grupe të ndryshme etnike** (nga gjuhë të ndryshme mësimore) dhe nga të dy gjinitë.

Nxënësit në këto puntori takohen më së **paku nga njëherë në javë** dhe puntoritë zgjat **më së paku një gjysëmvetor**.

#### Përgatitja

- në shkollë të formohen 4 çifte (për shkolla fillore) dy çifte (për shkolla të mesme) mësimdhënës nga gjuhët e ndryshme mësimore;
- çiftet e mësimdhënësve nga shkolla të ndjekin stërvitje për realizimin e puntorive multikulturore<sup>4</sup>;
- secili nga çiftet duhet të udhëheqë nga një **grup madhorë** nxënësish dhe me ta gjatë një gjysëmvetori të realizohen puntori multikulturore<sup>5</sup>;

<sup>4</sup>Stërvitja për mësimdhënës për realizimin e puntorive multikulturore është me karakter pune dhe përfshin mësim me përvojë, të përcjellur me diskutim për bazat teorike (sigurim i tretmanit të barabartë, dygjuhësi, metoda të punës etj.), si pjesë praktike në të cilën mësimdhënësit përgatisin dhe realizojnë pjesë nga puntoritë multikulturore nën supervisionin e trajnuesëve.

- çiftet e mësimdhënësve të përgatiten në mënyrë themeltare për secilën puntori, ndërkaq përgatitja përfshin përgatitjen e materialeve dhe përgatitjen e udhëheqjes së puntorisë në dy gjuhë;
- mësimdhënësit të zgjedhin nxënës për pjesëmarrje në punëtoritë multikulturore sipas kriteriumeve të caktuara paraprakisht për numrin dhe gjininë e nxënësve nga vitet e ndryshme mësimore dhe klasave
- mësimdhënësit në takimet me prindër t'i informojnë prindërit për punëtoritë dhe të sigurojnë pëlqim me shkrim për pjesëmarrje të fëmijëve të tyre, dhe
- përmes lajmërimit me shkrim në të gjitha gjuhët mësimore ( të vendosura në vende të theksuara), mësimdhënësit – realizatorë t'i informojnë pjesëmarrësit për vendin e mbajtjes së punëtorive multikulturore, i cili është i përcaktuar ashtu që t'u përgjigjet nxënësve nga gjuhë të ndryshme mësimore.

Në shkolla me përfaqësim të konsiderueshëm të nxënësve Rom, mund të realizohen edhe puntori multikulturore me fëmijë Rom dhe me fëmijë që nuk janë Rom dhe ata në dy mënyra:

1. kur nxënësit Rom dhe ata që nuk jnaë Rom mësojnë në të njejtën gjuhë, puntoritë multikulturore i udhëheqin dy mësimdhënës nga gjuha e njejtë mësimore dhe realizohen në një rën gjuhë dhe
2. kur nxënësit Rom dhe ata që nuk janë Rom mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore, punëtoritë multikulturore i udhëheqin dy mësimdhënës nga gjuhë të ndryshme mësimore dhe realizohen në dy gjuhë.

### Realizimi

- mësimdhënësit – realizatorë t'i realizojnë aktivitetet të organizuara në formën e punëtorive<sup>6</sup>, dy gjuhëshe, përmes metodës së parafrazimit dhe plotësimit;
- mësimdhënësit – realizatorë tërealizojnë puntori sipas rradhës, pa kërcime, por me mundësi të shtojnë puntori të reja paraprakisht të miratuara nga timi profesional, dhe
- në fund të realizimit të punëtorive, mësimdhënësit së bashku me pjesëmarrësit të përgatisin manifestim përfundimtarë qëllimi i së cilës është sigurimi i pamjes dhe promovim i produkteve të përbashkëta të përpunuara në puntori ( gjatë organizimit të manifestimit ndiqen kahet për shfaqje dhe manifestime)

### AKTIVITETET E LIRA TË NXËNËSVE-SEKSIONET

Të gjitha seksionet në shkollë duhet të jenë të përbashkëta -në to të marrin pjesë nxënësit nga të gjitha gjuhët mësimore, të udhëhequra nga ekipi i përzier etnik/gjuhësor.

Nxënësit nga të gjithë vitet shkollore dhe nga të gjitha gjuhët mësimore pritet që përmes anketës të japin propozime për formën e seksioneve të cilat do t'i kishin dashur t'i kenë në shkollë, pas së cilës mësimdhënësit duhet të formojnë seksione, duke respektuar prioritetet e nxënësve, kuptohet varësisht nga kushtet materiale hapsinore e profesionale që i posedon shkolla. Secilin seksion duhet ta udhëheqin më së paku dy mësimdhënës nga të gjitha gjuhët mësimore të cilët së bashku e përgatisin programin për punë. Përmes lajmërimit me shkrim në të gjitha gjuhët mësimore (të vendosur në vende të dukshme), mësimdhënësit – realizatorë i informojnë pjesëmarrësit për kohën dhe vendin e mbajtjes së seksioneve, i cili është i caktuar ashtu që t'u përgjigjet nxënësve nga gjuhë të ndryshme mësimore.

Përcjellin kahe për disa aktivitete të lira, të cilët mund të shërbejnë si shembull për të gjithë të tjerët që shkolla

„Me planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve të lira të nxënësve duhet të vendoset qasje bashkëkohore e cila do të mundësojë pjesëmarrje aktive të nxënësve në më shumë faza, duke filluar nga zgjedhja..., e deri te angazhimi i nxënësve për zbatimin e tyre në shkollë, në mjedis dhe jetë”

(Nga Koncepti për edukim dhe arsim fillor , shkurt . viti, 2007, fq.110)

<sup>5</sup>Puntoritë multikulturore janë të përgatitura nga ana e Qendrës për të drejtat e njeriut dhe zgjidhjes së konflikteve, në kuadër të projektit “ Shkolla sipas masës së fëmijës” të cilën e financoi UNICEF, ndërsa u realizua në bashkëpunim me Ministrinë e arsimit dhe shkencës dhe Biorosë për zhvillimin e arsimit. Për nevojat e këtij programi janë përgatitur doracakë të veçantë (njëri për shkollat fillore dhe tjetri për shkollat e mesme) në gjuhën maqedone, gjuhën shqipe dhe gjuhën turke, të dedikuara për mësimdhënës- realizatorë të punëtorive.

<sup>6</sup>Strukturën e punëtorive multikulturore e ndjek struktura e punëtorëve për Arsimin e shkathtësive jetësore, të cilët janë përgatitur nga ana e Qendrës për të drejtat e njeriut dhe zgjidhjes së konflikteve në kuadër të projektit “Shkollë sipas masës së nxënësve” që e financoi UNICEF, ndërsa u realizua në bashkëpunim me Ministrinë për arsim dhe shkencë dhe Biorosë për zhvillim.

rëndom i organizon ose ka qëllim t'i organizojë.

### Seksioni i dramës

Mësimdhënësit nga të dy/tre gjuhët mësimore të përfaqsuara në shkollë bashkëpunojnë në përgatitjen e aktivitetit. Prej tyre, si tim, pritët:

- të zgjedhin tekste dhe përmbajtje të cilat promovojnë multikulturë, tolerancë dhe respektim ( përmes përbërjes, përmbajtjeve dhe sjelljes së pjesmarrësve në sekcion); dhe
- gjatë zgjedhjes së formës të shfaqjes të kenë parasysh se ajo mund të realizohet: (a) pa fjalë ( me pantomimë, hije, dans...); (b) me të folur në gjuhët në të cilat zhvillohet mësimi ( në të dy/tre gjuhët mësimore – pa dominim të gjuhës/ve të/së caktuar/a ku secili “aktorë”flet në gjuhën në të cilën e ndjek mësimin, ndërsa përkohësisht dy/tre “aktorë” në rolin e lajmëruesit shkurtimisht e rezimojnë të thënë, ose (c) me të folur në gjuhë të huaj të cilën e dinë të gjithë nxënësit në shkollë;
- gjatë shpërndarjes së roleve të kenë kujdes në numrin e barabartë të roleve kryesore të kenë nxënësit nga grupet e ndryshme etnike/gjuhësore;
- në organizimin e shfaqjes sipas mundësisë të përfshihen edhe nxënës nga seksioni i arsimit figurative, me përpunimin e ftesave, programit, plakatave dhe materialit të ndryshëm propagandistik i cili në tërësi duhet të jetë i përgatitur ose në të gjithë gjuhët mësimore ose në gjuhë të huaj në të cilën realizohet shfaqja.

### Kori

Mësimdhënësit e të dy/tre gjuhëve mësimore bashkëpunojnë në përgatitjen dhe realizimin e aktivitetit. Prej tyre, si ekip, pritët :

- nëse në shkollë ekzistojnë kore të veçanta të gjuhëve të ndryshme mësimore, t'i bashkojnë në një kor të përbashkët;
- nëse në shkollë ka kor i cili është i përbërë kryesisht nga nxënës prej një gjuhe mësimore, të plotësojnë me numër të balancuar të nxënësve edhe të gjuhës/ve tjetër/a mësimore;
- nëse për herë të parë formohet kori, së bashku të marrin pjesë në selektimin e nxënësve, sipas kriteriumeve të paracaktuara;
- në të gjitha shfaqjet dhe garat kori të shfaqet bashkërisht;
- të përfshijnë numër të njejtë të këngëve të cilat janë karakteristike për secilin grup etnik/gjuhësor, të cilët janë me kohëzgjatje dhe peshë të njejtë të këndimit.
- të përfshijnë këngë të cilat janë të përbashkëta për nxënësit e të gjitha grupeve etnike/gjuhësore (për shembull këngë popullore e cila në të njejtën melodi do të këndohet në gjuhë të ndryshme mësimore, këngë për fëmijë për festim të ditëlindjes
- të përfshijnë këngë të cilat nuk kanë simbole të veçanta etnike/gjuhësore, por janë në gjuhë të huaja;
- gjatë mësimit të këngës detyrimisht të sigurojnë përkthim të njejtës në të gjithë gjuhët dhe të sqarojnë kuptimin e saj;
- të gjithë këngët ( pavarësisht nga gjuha ) t'i këndojnë gjithë nxënësit e korit;
- disa nga këngët e “përbashkëta” kori t'i këndojë një strofë në njëren gjuhë, pastaj një strofë në gjuhën tjetër mësimore etj.;
- gjatë përgatitjes së repertoarit për festa të veçanta karakteristike vetëm për njërin grup etnik/gjuhësor , të inkuadrojnë së paku nga një këngë të gjuhëve tjera mësimore e cila për nga përmbajtja e saj duhet t'i referohet pandan festës grupit/ve tjetër /tjera etnike; dhe
- të dirigjojnë në mënyrë reciproke dhe, sipas mundësisë, t'i dirigjojnë këngët të cilat janë në gjuhë të ndryshme mësimore nga ajo që realizohet mësimi.

Në shkolla me përfaqsim të konsiderueshëm të nxënësve Rom, gjatë përpilimit të repertoarit të kihet kujdes që të ketë këngë të cilat janë karakteristike për bashkësinë rome në përfaqsim të barabartë sikurse edhe bashkësive tjera etnike dhe të njejtat mund të këndohen në gjuhën rome.

## Seksioni i fotografisë

Mësimdhënësit e të dy/tre gjuhëve mësimore bashkëpunojnë në përgatitjen dhe realizimin e aktiviteteve. Prej tyre, si ekip, pritet:

- të zgjedhin tema për fotografim të cilët mundësojnë njohjen dhe respektimin e ngjajshmërive dhe dallimeve të bashkësive të ndryshme etnike/gjuhësore në shkollë.
- t'i organizojnë nxënësit në çifte ose time të përziera etnike/gjuhësore të cilët së bashku duhet të fotografojnë tema të caktuara.
- t'i përgatisin nxënësit për atë se si të sillen dhe si të reagojnë në rast se nuk gjejnë mirëkuptim për shkak se janë në përbërje të përzier etnike/gjuhësore;
- ftesat dhe katalogu i ekspozitës si dhe tekstet nën fotografi t'i shkruajnë në të gjitha gjuhët mësimore të përfaqsuara në shkollë, dhe
- gjatë kohës së ekspozitës t'i organizojnë çiftet ose grupet e nxënësve me përbërje të përzier etnike/gjuhësore të qëndrojnë afër punimeve të përbashkëta dhe vizitorëve t'ju sqarojnë në gjuhën në të cilën vizitorët u drejtohen.

### EKIPET SPORTIVE

Të gjitha ekipet sportive në shkollë duhet të jenë të përbashkëta dhe në to të marrin pjesë nxënësit nga të gjitha bashkësitë etnike/gjuhësore të përfaqsuara në shkollë, si gjatë mbajtjes së stërvitjeve, ashtu edhe gjatë garave zyrtare.

Shkolla mund të formojë dy lloje ekipe sportive: njëri rekreativ ( për të gjithë nxënësit e interesuar të cilët dëshirojnë të merren me sport, pa dallim të aftësive dhe paradispozitave të tyre) dhe njëri garues ( për nxënës me aftësi dhe të aritura më të mira).

## Përgatitja

Secilin ekip sportiv e stërvisin më së paku dy mësimdhënës nga gjuhët e ndryshme mësimore, të cilët bashkëpunojnë në përgatitjen e aktivitetit. Nëse shkolla ka mundësi për formimin e ekipeve në më shumë sporte, atëherë mundet që mësimdhënësi i arsimit për kulturë fizike dhe sport, i një gjuhe mësimore të udhëheq ekip në një sport, ndërkaq tjetri në sport tjetër. Në këtë rast është e nevojshme që ta kenë për ndihmës edhe mësimdhënës nga gjuha tjetër mësimore, nëse ka afinitet dhe shkathtësi për sportin e dhënë. Si ndihmës mund të angazhohen edhe prindër të cilët i posedojnë shkathtësitë adekuate sportive, por gjatë kësaj duhet patur kujdes që mos të prishet balanci etnik i ekipit trajnues.

Prej tyre pritet që:

- në tabelën e shpalljeve të vendosin thirrje për paraqitje të nxënësve në ekipe sportive nga të dy/tre gjuhët mësimore dhe të përcaktojnë termin për stërvitje në kohën në të cilën mund të marrin pjesë nxënësit nga të dy/tre gjuhët mësimore;
- bashkërisht dhe njëkohësisht të bëjnë selektimin e nxënësve të cilët e përbëjnë ekipin e parë në bazë të kritereve të caktuara paraprakisht në raport me shkathtësitë sportive të nxënësve dhe gjatë kësaj duhet të insistojnë që në ekipin e parë të ketë më së shumti deri në dy të tretat pjesëmarrës nga njëri grup etnik/gjuhësor, dhe
- të organizojnë stërvitje me nxënësit e interesuar me shkathtësi më të ulta sportive që t'i barazojnë me nxënësit tjerë, me qëllim që të tejkalohen dallimet në shkathtësitë fillestare sportive të nxënësve nga grupet e ndryshme etnike/gjuhësore ( të cilat më së shumti dalin nga fakti se për shkak të shkaqeve objektive dhe subjektive , disa stërviten në klube sportive, ndërkaq të tjerët jo).

## Realizimi

Trainerët në disa nga stërvitjet e para duhet të realizojnë loja të ndryshme për njohje dhe bashkëpunim, ndërsa edhe mëtej secilën stërvitje është mirë që ta fillojnë me lojë të tillë. Ata duhet së bashku të punojnë me të gjithë nxënësit, por mundet edhe t'i ndajnë nxënësit në grupe më të vogla sipas teknikës që duhet ta ushtrojnë, e jo sipas përkatësisë etnike/gjuhësore.

Trainerët, duke bashkëpunuar ndërmjet tyre, duhet të sigurojnë edhe këtë;

- emrin e klubit, ngjyrën e fanelave, mbishkrimet dhe emblemet e fanelave të zgjedhen me konsensus nga ana e tërë ekipit (trainerët dhe lojtarët së bashku); në shfaqjet zyrtare të ekipit në gara nxënësit paraqiten me fanela në të cilat emri i klubit dhe mbishkrimet tjera janë të shkruara në të gjitha gjuhët mësimore të përfaqsuara në shkollë, dhe
- në gara, grupet e tifozëve pritet që të këndojnë këngë në të dy/tre gjuhët mësimore dhe të bartin parulla/transparente të cilat gjithashtu janë në dy/tre gjuhë; gjatë zgjedhjes së këngëve për tifozeri duhet patur kujdes që të mos ketë përmbajtje ofenduese dhe jo të pëlqyeshme për akëcilin grup etnik, si dhe të mos jenë etnocentrike.

### **GARA NDËRSHKOLLORE**

Në të gjitha garat shkollore në nivel komunal, qyteti dhe shteti, shkolla duhet të marrë pjesë me ekip të cilën e përbëjnë nxënësit nga grupet e ndryshme etnike/gjuhësore nën udhëheqjen e mësimitdhënësve nga gjuhë të ndryshme mësimore.

Të gjitha lajmërimet dhe shpalljet për paraqitje në gara duhet të shkruhen në të gjitha gjuhët mësimore, ndërsa pas zgjedhjes së nxënësve, i tërë procesi i përgatitjeve për gara duhet të realizohet me nxënës nga të dy/tre gjuhët mësimore në atmosferë të bashkëpunimit dhe ndihmës. Gjatë përgatitjeve, mësimitdhënësit përgjegjës duhet t'i përgatisin të gjitha detyrat dhe materialet të cilat jepen në formë të shkruar dygjuhëshe/tregjuhëshe.

### **AKTIVITETET HUMANITARE NË BASHKËSI**

Mësimitdhënësit përgjegjës mund të zgjedhin një ose më shumë aktivitete humanitare në bashkësi ( ofrimi i ndihmës nxënësve në mësim ose personave të rrezikuar social dhe/ose kujdes për persona të moshuar , shoqërim me fëmijë nga shtëpia e fëmijëve pa prindër,

realizimi i akcioneve për mbledhjen dhe distribuimin e ndihmës humanitare në bashkëpunim me Kryqin e Kuq dhe Gjysëmshënën e kuqe e tjerë) të cilat do të kërkojnë të zbatohen me nxënës me përbërje të përzier.

Nëqoftë se shkolla në programin e saj ka të definuar paraprakisht se çfarë tip aktivitetesh humanitare do t'i ndërmer gjatë vitit shkollor, mësimitdhënësit përgjegjës mund të bëjnë analizë që të vërtetojnë se cilat prej tyre janë më adekuate për realizimin me nxënës me përbërje të përzier etnike/gjuhësor. Nëse shkolla nuk ka parashikuar këso lloj aktivitetesh, mësimitdhënësit përgjegjës mund të propozojnë një ose më shumë aktivitete të cilat do të realizoheshin në periudhën prej më së paku një gjysëmvetor.

Në vijim pason shembulli i aktivitetit humanitar në bashkësi, i cili mund të shërbejë si ide dhe/ose si model për për realizimin e aktiviteteve të ngjajshme.

#### **Ndihmë personave të moshuar**

Mësimitdhënësit përgjegjës nga gjuhë të ndryshme mësimore, së bashku me përfaqësues të Këshillit të prindërve, duhet të hartojnë listën e personave të moshuar ( farefis të nxënësve dhe/ose persona tjerë të moshuar nga rrethina ) të cilëve u duhet ndihmë në realizimin e aktiviteteve të përditëshme.

Nxënësit nga përkatësia e ndryshme etnike/gjuhësore, të ndarë në çifte ose grupe, duhet të realizojnë biseda fillestare me persona të moshuar që të zbulojnë se çfarë lloj ndihme u është e nevojshme dhe të njejtat t'i vendosin në listë ( për shembull, furnizimi me mjete për plotësimin e nevojave ditore, leximi i gazetave ditore, komunikimi përmes internetit, lojë me letra, shah...). Pastaj, çiftet/grupet e nxënësve zgjedhin një ose më shumë punë nga lista të cilat do të mund t'i bëjnë dhe e realizojnë aktivitetin që e kanë zgjedhur të të gjithë njerëzit e moshuar të cilëve u nevojitet.



### 3.3. Zbatimi i aktiviteteve të përbashkëta mësimore

#### ORË PËR GJUHË TË HUAJ

Secila orë për gjuhë të huaj e cila mësohet në mësimin e rregullt kohë pas kohe mund të mbahet me grup të përzier etnik që ndjekin mësim në gjuhë të ndryshme. Me këtë rast, nga dy paralele me gjuhë të ndryshme mësimore krijohen dy grupe të “përziera” dhe njëri e udhëheq mësimdhënësi i cili u ligjëron nxënësve të cilët e ndjekin mësimin në njëri gjuhë mësimore, ndërsa tjetri, mësimdhënësi që u ligjëron nxënësve që ndjekin mësimin në gjuhën tjetër mësimore.

Rekomandohet që së paku dy herë në muaj të ketë orë të përbashkët për gjuhë të huaj që të mundet aktiviteti i përbashkët t’i jep efektet e pritura.

#### Përgatitja

Nga mësimdhënësit përgjegjës për gjuhë të huaj pritet :

- të bëjnë planifikim të përbashkët të mëimit së paku për gjithë gjysëmvetorin dhe të mbajnë llogari me që me tempo të njetë t’i realizojnë përmbajtjet e parashikuara;
- të bëjnë planifikim të përbashkët të orëve të cilat do t’i mbajnë së bashku;
- të përgatisin aktivitetet për njohje reciproke në mes nxënësve që nga takimi i parë i përbashkët;
- të kenë takim të dakorduar para secilës orë të përbashkët që ta përshtasin udhëheqjen e orës;
- për secilën orë të përgatisin fjalor trigjuhësor të fjalëve të panjohura ose të fjalëve të reja nga gjuha e huaj të cilat shfaqen gjatë përpunimit të përmbajtjes së orës.
- të dakordojnë termin të përbashkët për mbajtjen e orëve në të njetën kohë për të dy grupet e përziera.

#### Realizimi

Gjatë realizimit të orës së përbashkët për gjuhë të huaj, duhet të ndiqen drejtimet vijuese:

- mësimdhënësit të flasin vetëm në gjuhën e huaj, pa përdorur gjuhët lokale ( shprehje/ fjalë të gjuhëve lokale përdoren nga nxënësit vetëm gjatë plotësimit të listës së fjalëve të panjohura);
- secili mësimdhënësi t’u drejtohet dhe në mënyrë aktive t’i dëgjojë nxënësit nga të dy gjuhët e përfaqsuara mësimore;
- gjithmonë kur bëhet fjalë për grupe të vogla, grupet të jenë të përbëra nga nxënës që ndjekin mësimin në të dy gjuhët mësimore;
- në punën grupore mësimdhënësi t’i inkurajojë të gjithë nxënësit që të bashkëpunojnë në mes veti , pavarësisht nga përkatësia etnike e tyre, dhe
- secili arsimtar t’i lavdërojë të gjithë nxënësit, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike ( secili lavdërim i nxënësit që ndjek mësimin në njëri gjuhë duhet të përcillet me lavdërimin edhe të nxënësit që ndjek mësimin në gjuhën tjetër mësimore.

#### ORËT PËR ARSIM FIZIK DHE SHËNDETËSOR

Është mirë që së paku dy herë në muaj të ketë orë të përbashkëta të edukimit/arsimit fizik të cilat do të përfshijnë dy paralele nga viti i njetë që ndjekin mësim në gjuhët të ndryshme mësimore. Orët e përbashkëta do të udhëhiqen nga mësimdhënësi që e realizojnë mësimin në këtë lëndë mësimore dhe në të dy gjuhët mësimore. Gjatë kësaj, orët e përbashkëta do të organizohen ose në salla sportive ose në terene sportive dhe do të përfshiheshin kryesisht aktivitete të cilat kërkojnë sqarim të veçantë, për shkak se nxënësit janë paraprakisht të njohur mirë ( në orë ose jashtë orëve) me ate se si do të zhvillohen aktivitetet e caktuara.

#### Përgatitja

Nga mësimdhënësit përgjegjës pritet:

- të bëjnë planifikimin e përbashkët së paku për një gjysëmvetorë të tërë dhe të mbajnë llogari që me tempo të njetë t’i realizojnë temat e përcaktuara;
- të bëjnë planifikim të përbashkët të orës mësimore të cilin do ta mbajnë së bashku;

- të përgatisin aktivitete për njohje reciproke të nxënësve që në takimin e parë ( në vend se t'i vënë nxënësit në situatë konkrete, duke pritur që të njihen në mënyrë spontane);
- në secilën orë mëimore të paraprijë takimi i përbashkët i mësimdhënësve për përshtatjen e udhëheqjes së përbashkët të orës mëimore, dhe
- të dakordojnë termin të përbashkët për mbajtjen e orëve mëimore.

### Realizimi

Gjatë realizimit të orës së përbashkët mëimore mësimdhënësit duhet:

- të flasin në gjuhën në të cilën e zhvillojnë mësimin, por të kenë kujdes që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve që zhvillohen në orë mëimore, të dy gjuhët të përfaqsohen në mënyrë të barabartë ;
- gjatë ndarjes së nxënësve në ekipe, në grupe më të vogla ose çifte me përkatësi etnike të përziera, çdo herë të kenë kujdes që grupet të kenë përbërje të përziera etnike të nxënësve që ndjekin mësimin në dy gjuhët e përfaqsuara;
- t'i inkurajojnë të gjithë nxënësit që të mund të kenë qasje tek mësimdhënësit, pavarësisht nga përkatësia etnike apo gjuha e tyre mëimore;
- të bashkëpunojnë dhe të plotësohen në mes veti gjatë kohës së udhëheqjes së aktiviteteve;
- t'i inkurajojnë të gjithë nxënësit të bashkëpunojnë në mes veti pavarësisht nga përkatësia etnike dhe gjuha e tyre mëimore, dhe
- t'i lavdërojnë të gjithë nxënësit pavarësisht përkatësisë së tyre etnike, duke u kujdesur sidomos që mësimdhënësi nga njëra gjuhë mëimore t'i lavdërojë kryesisht nxënësit nga gjuha tjetër mëimore.

### ORË PËR ART FIGURATIV

Një pjesë e orëve për art figurativ mund të organizohen bashkërisht me nxënës nga dy paralele nga viti i njëjtë të cilat ndjekin mësim në gjuhë të ndryshme mëimore të udhëhequra nga mësimdhënësi që mbajnë mësim për art figurative në gjuhë të ndryshme mëimore. Pritet që së paku një herë në

muaj të ketë orë të përbashkët nga arti figurativ. Me këtë rast, orët e përbashkëta do të organizohen rreth realizimit të punës praktike.

### Përgatitja

Nga mësimdhënësit përgjegjës pritet:

- të bëjnë planifikim të përbashkët të mëimit së paku për një gjysëmvetor të tërë dhe të mbajnë llogari që me tempo të njëjtë t'i realizojnë përmbajtjet e parshikuara;
- të bëjnë planifikim të përbashkët të orës mëimore të cilën do ta mbanin së bashku;
- të përgatisin aktivitet për njohje të ndërsjellë të nxënësve qysh gjatë takimit të parë;
- në secilën orë të përbashkët të paraprijë takimi i përbashkët i mësimdhënësve për përshtatjen e udhëheqjes së përbashkët të orës, dhe
- të dakordojnë termin të përbashkët për mbajtjen e orëve të përbashkëta.

### Realizimi

Gjatë realizimit të punës praktike në lëndën art figurativ, mësimdhënësit duhet:

- t'i ndajnë nxënësit në çifte të përziera ose në grupe të vogla të përziera, të formuara nga nxënës që e ndjekin mësimin në gjuhët e përfaqsuara ( me ç'rast grupet e vogla duhet të jenë të balancuara për nga numri i nxënësve që mësojnë në gjuhë të ndryshme mëimore);
- të flasin kryesisht në gjuhën me të cilën e zhvillojnë mësimin, mirëpo të kenë kujdes që të dy gjuhët të përfaqsohen në mënyrë të barabartë në udhëheqjen e aktiviteteve që realizohen në orë;
- t'u drejtohen dhe në mënyrë aktive t'i dëgjojnë nxënësit nga grupi i ndryshëm gjuhësor dhe në mënyra të ndryshme të përpiqen të kuptojnë sa është e mundur më shumë atë që thuhet;
- të bashkëpunojnë dhe të plotësohen në mes veti gjatë kohës së udhëheqjes së aktiviteteve;
- në punën grupore t'i inkurajojnë të gjithë nxënësit të bashkëpunojnë në mes veti pavarësisht nga përkatësia etnike dhe gjuha e tyre mëimore, dhe
- t'i lavdërojnë të gjithë nxënësit, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike, duke u kujdesur sidomos ashtu që arsimtari nga njëra gjuhë mëimore t'i lavdërojë kryesisht nxënësit nga gjuha tjetër mëimore.

## MËSIMI NË NATYRË NË SHKOLLAT FILLORE

Për nxënësit e klasës së IV të cilët mësojnë në gjuhë të ndryshme

mësimore të përfaqsuara në shkollë pritet që mësimi në natyrë të organizohet në kohë të njëjtë dhe në vend të njëjtë. Me këtë rast, orët për lëndët për të cilat mund të realizohen aktivitete praktike ose aktivitete të realizuara duhet të zbatohen në grupe të përziera etnike/gjuhësore: dy paralele nga dy ( ose tre ) gjuhë të ndryshme mësimore bashkohen dhe së bashku i realizojnë përmbajtjet për të cilat nuk nevojitet shumë shprehje gojore, por kërkojnë më shumë punë praktike. Gjatë një viti shkollor pritet që mësimi në natyrë të organizohet një herë me kohëzgjatje prej tre deri në tetë ditë.

„Në prag të realizimit, e më së voni shtatë ditë para realizimit të ekskursioneve ose aktiviteteve tjera të lira, udhëheqësi i klasës organizon takim me nxënësit dhe prindërit e tyre, me ç'rast i informon dhe u jep sqarime detajuese për programin i cili do të realizohet.“

(Nga Rregullorja për mënyrën e realizimit të ekskursioneve shkolloredhe aktiviteteve tjera të lira të nxënësve të shkollave fillore, neni 25)

### Përgatitja

Mësimdhënësit përgjegjës me gjuhë të ndryshme mësimore bashkëpunojnë në përgatitjen e mësimit në natyrë. Prej tyre, si ekip, pritet:

- të përgatisin program ( të zgjedhin temë/përmbajtje, të definojnë qëllime dhe të dakordojnë plan për punë me detyra konkrete);
- të sigurojnë që Këshillat shkollorë nga të dy shkollat partnere ta miratojnë programin mbi bazën e mendimeve të marra nga Biroja për zhvillimin e arsimit, Këshilli i prindërve dhe Këshilli i komunës;
- të mbajnë mbledhje prindore ( në të dy shkollat) në të cilat do ti njoftojnë prindërit me organizimin e mësimit në natyrë dhe të sigurojnë lejen e tyre ( më së paku 70% nga prindërit e nxënësve në secilën klasë) për realizimin e mësimit të përbashkët në natyrë, dhe
- të përpilojnë listë dygjuhëshe për nocionet kyçe në të cilat do të mund të referohen dhe t'i vënë në lidhshmëri gjatë realizimit të aktiviteteve të përbashkëta të mësimit në natyrë.

### Realizimi

Nxënësit të cilët mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore, në shoqërim të mësimdhënësve, së bashku të udhëtojnë deri te vendi/ vendet i parashikuar për realizimin e mësimit në natyrë dhe së bashku të kthehen pas përfundimit të tij.

Gjatë realizimit të aktiviteteve të parashikuara mësimdhënësit, duhet të mbajnë llogari për punët në vijim:

- të flasin në gjuhën në të cilën e udhëheqin mësimin, por të kenë kujdes që të dy gjuhët të përfaqsohen në mënyrë të barabartë gjatë udhëheqjes së aktiviteteve;
- të dy gjuhët të përdoren në mënyrë të barabartë dhe reciproke ( njëra gjuhë të mos shërbejë vetëm për përkthim);
- t'u drejtohen dhe në mënyrë aktive t'i dëgjojnë nxënësit nga grupi i ndryshëm gjuhësor dhe në mënyra të ndryshme të përpiqen sa është e mundur ta kuptojnë atë çka thuhet;
- të bashkëpunojnë dhe të plotësohen në mes veti gjatë udhëheqjes së aktiviteteve ( për shembull, disa nga nocionet themelore të përgatitura paraprakisht në lidhje me temën të dy mësimdhënësve t'i tregojnë në të dy gjuhët);
- sipas nevojës, të formojnë grupe të vogla dhe atë me nxënës me përkatësi etnike dhe gjinore të përziera dhe në punën grupore t'i inkurajojnë të gjithë nxënësit të bashkëpunojnë në mes veti, pavarësisht përkatësisë së tyre etnike, dhe
- t'i lavdërojnë të gjithë nxënësit, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike.

## PROJEKT AKTIVITETET NË ARSIMIN GJIMNAZOR

Projekt aktivitetet, të parashikuara edhe në planin mësimor për arsimin e mesëm gjimnazor, mund të organizohen edhe me grupe të përziera nxënësish që ndjekin mësim në gjuhë të ndryshme mësimore. Në këtë rast, projekt aktivitetet realizohen në mënyrë bilinguale, të udhëhequra nga dy mësimdhënës të cilët realizojnë mësim në gjuhët e përfaqsuara mësimore.

Sipas planit mësimor për arsim gjimnazor i përpiluar nga ana e Birosë për zhvillimin e arsimit, aktivitetet projektuese mund të organizohen në lëmitë vijuese: kultura e jetës së shëndetëshme, paqa dhe tolerance, kultura urbane, kultura qytetare, aktivitetet sportive, aktivitetet nga lëmia e muzikës, aktivitetet krijuese figurative dhe artistike, klubet letrare dhe seksionet e dramës, afarizmi etj.

Gjatë formimit të grupit, mësimdhënësit nga gjuhët e ndryshme mësimore mund të ofrojnë temë të caktuar nga lëmia e dhënë dhe të paraqesin shpallje për paraqitjen e nxënësve për pjesëmarrje në projekt aktivite me temë të tillë, mirëpo mundet të zbatojnë edhe anketë në mes nxënësve për t'i njohur preferencat e tyre për tema të mundëshme rreth së cilave do të organizoheshin projekt aktivitetet. Mënyra tjetër do të ishte kur mësimdhënësit së pari formojnë grupe nxënësish të balancuara etnike dhe gjinore për punë në lëmi të caktuar, e pastaj në takimin e parë të përbashkët të definohet tema në të cilën do të punonin.

Duke u mbështetur në atë se projekt aktivitetet organizohen jashtë nga mësimi i rregullt, mund të realizohen edhe në ditët e shtuna në formën e bllok orëve. Sipas planit mësimor për arsim gjimnazor, projekt aktivitetet duhet të realizohen me gjithsejt 36 orë gjatë një gjysëmvetori.

### Përgatitja

Nga mësimdhënësit të cilët së bashku do të udhëheqin projekt aktivite pritet si vijon:

- bashkërisht të përgatisin program me hapa konkret për realizimin e projekt aktiviteve me përbërje të nxënësve me përkatësi të përzier etnike ;
- të formojnë grupe etnike dhe gjinore të balancuara me numër të përgjithshëm prej 20-24 nxënës.
- Të përcaktojnë termin ( kohën dhe vendin) për realizim të projekt aktiviteve dhe të njejtin t'a vendosin të shkruar në vend të theksuar;
- Të sigurojnë materiale të nevojshme për realizimin e projekt aktiviteve, dhe
- Në secilën orë të përbashkët të paraprijë takim i përbashkët për përshtatjen e udhëheqjes së përbashkët të orës.

### Realizimi

Gjatë realizimit të orëve për projekt detyra mësimdhënësit duhet t'i respektojnë drejtimet vijuese:

- të flasin kryesisht në atë gjuhë mësimore në të cilën ligjërojnë, por të mundësojnë që gjuha të konsiderohet si mjet për lehtësimin e komunikimit të ndërsjellë;
- të dy gjuhët të përdoren në mënyrë reciproke dhe të barabartë ( njëra gjuhë të mos përdoret vetëm për përkthim);
- në mënyrë të barabartë t'i trajtojnë të gjithë nxënësit ( t'u drejtohen edhe nxënësve tjerë, e jo vetëm atyre nga gjuha e "vetë" mësimore);
- sipas nevojave të aktiviteve, t'i organizojnë nxënësit në çifte ose ekipe të përziera etnike/ gjuhësore të cilët së bashku do të kryejnë detyrë të caktuar;
- prezentimi i produkteve nga projekt aktivitetet të bëhet në mënyrë bilinguale, me pjesëmarrje të nxënësve nga gjuhë të ndryshme mësimore dhe të gjitha materialet të jenë të përgatitura në mënyrë bilinguale;
- gjatë prezentimit të produkteve nga orët e përbashkëta mësimore, ftesat dhe katalogu për ekspozitë, si dhe tekstet nën fotografitë të jenë të shkruara në të gjitha gjuhët mësimore të përfaqsuara gjatë prezentimit të aktiviteve,
- nëqoftë se ka ekspozitë të organizojnë që gjatë kohës së ekspozitës çiften ose grupet e nxënësve në përbërje të përzier etnike/gjuhësore të qëndrojnë afër veprave të përbashkëta dhe t'u sqarojnë vizitorëve në gjuhën në të cilën u drejtohen vizitorët.

## ORËT E LIRA NË SHKOLLAT PROFESIONALE

Orët e lira të parashikuara në planin mësimorë për arsim në shkollat e mesme profesionale mund të organizohen edhe në grupe të përziera, me nxënës me gjuhë të ndryshme mësimore. Me këtë rast, orët e lira realizohen në mënyrë bilinguale, të udhëhequra prej dy mësimdhënësve të cilët ligjërojnë në gjuhë të ndryshme mësimore.

Siç është e definuar në Udhëzuesin për përgatitjen e programeve për orë të lira të shkollës në arsimin e integruar<sup>7</sup>, programet për orë të lira i përgatisin vet mësimdhënësit nga shkollat dhe gjatë kësaj mund të zgjedhin ndërmjet dy qasjeve të ndryshme:

*Qasja 1.* Përmbajtjet profesionale të cilat janë specifike dhe të rëndësishme për profesionin/profilin arsimor, përvetësohen ashtu që vendosen në kontekstin multietnik/multikulturor.

*Qasja 2.* Nxënësit vendosen drejtpërdrejt në situatë t'i përvetësojnë përmbajtje multietnike/multikulturore të cilat promovojnë dygjuhësi, respektim të dallimeve dhe bashkëpunim të ndërsjellë. Mësimdhënësit të cilët do të vendosin për qasjen e dytë për realizimin e orëve të lira mund të zgjedhin që ta zbatojnë programin tash më të njohur "Puntoritë multikulturore për shkolla të mesme", i cili është i dhënë në gjuhën maqedonase, gjuhën shqipe dhe në gjuhën turke.

### Shembull për orë të integruara

Si shembull për qasjen e parë mund të shërbejë program *Përdorimi i ornamenteve në veshjen popullore në Republikën e Maqedonisë*, i cili i vë nxënësit e drejtimit tekstil-lëkurë në situatë që të hulumtojnë për veshjet nga të dy bashkësitë etnike të cilët do t'i përcaktojnë llojin e materialit prej të cilit është përpunuar, si dhe ornamentet, ngjyrat, zbukurimet dhe detajet tjera që janë përdorur gjatë përpunimit të tyre. Gjithashtu, duhet të dinë edhe për atë se cili është roli dhe rëndësia për veshjen konkrete, në cilën periudhë kohore janë përdorur, për cilën rrethinë dhe për cilën bashkësi etnike janë të njohura. Si produkt përfundimtarë mund të bëhet një përmbledhje nga veshjet popullore dhe të organizohet revy mode si mënyrë për prezentim.

Shembull për qasjen e dytë është *Programi për hulumtimin e traditave dasmore nga të dy etnitetet* e cila kërkon prej nxënësve nga grupi i përzier etnik/gjuhësor të hulumtojnë për traditat e dasmave të njëri tjetrit. Analizohet kohëzgjatja e dasmës (përgatitjet para dasmës, gjatë dasmës dhe pas dasmës), ceremonitë, misafirët, muzika, zakonet, veshja, hyrja e nuses në shtëpi etj. )

Hulumtimi realizohet në teren përmes bisedave me gjenerata të ndryshme nga regjione të ndryshme dhe nga statuse të ndryshme sociale. Rezultatet e fituara nga puna hulumtuese mund të jenë në formë të: dramatizimit, broshurave, gazetës së murit, albumit, posterit etj.

(Nga Udhëzuesi për përgatitjen e programeve për orë të lira të shkollës në arsimin e integruar)

### Përgatitja

Nga mësimdhënësit të cilët në mënyrë të përbashkët do t'i udhëheqin orët e lira pritet:

- bashkërisht ta përgatisin programin për realizimin e orëve të lira me nxënës në grupe të përziera etnike nga dy shkolla partnere me gjuhë të ndryshme mësimore;
- t'ia prezantojnë programin Bashkësisë së klasës para nxënësve dhe të mundësojnë paraqitjen e nxënësve sipas kriteriumeve paraprakisht të përcaktuara;
- të formojnë grup të balancuar etnik dhe gjinor me numër të përgjithshëm prej 20 nxënësve;
- të përcaktojnë termin (kohën dhe vendin) për realizimin e orëve të lira të cilin në formë të shkruar do ta vendosin në të dyja shkollat në vende të theksuara (orët e lira të organizohen edhe si bllok orë, dy orë në një termin dhe mund të realizohen edhe gjatë kohës së vikendit);
- në secilin takim të përbashkët të paraprijë dakordimi i përbashkët për përshtatjen e realizimit të aktiviteteve.

<sup>7</sup> Udhëzuesi për përgatitjen e programeve për orë të lira të shkollës të arsimit të integruar është përgatitur nga ana e Qendrës për arsim dhe trajnim profesional në kuadër të projektit "Mësojmë së bashku" të Ambasadës së Mbretërisë së Norvegjisë në bashkëpunim me Ministrinë për arsim dhe shkencë.

- të sigurojnë materiale të nevojshme për realizimin e orëve mësimore në varësi me kërkesat e programit, dhe
- në secilën orë të përbashkët të paraprijë dakordim i përbashkët/ takim për përshtatjen e udhëheqjes së përbashkët të orës.

### Realizimi

Gjatë realizimit të orëve mësimdhënës nga të dy shkollat partnere duhet të ndjekin drejtimet vijuese:

- sipas nevojës, orët t'i mbajnë edhe nëpër shtëpi, muze, biblioteka, organizata joqeveritare dhe institucione tjera;
- të flasin kryesisht në atë gjuhë mësimore në të cilën ligjërojnë, mirëpo të mundësojnë që gjuha të konsiderohet si mjet i cili shërben për lehtësimin e komunikimit të ndërsjellë;
- të dy gjuhët t'i përdorin në mënyrë reciproke dhe të barabartë (njëra gjuhë të mos shërbejë vetëm për përkthim)
- në mënyrë të barabartë të trajtohen të gjithë nxënësit (tu drejtohen edhe nxënësve tjerë, e jo vetëm atyre të gjuhës së "vet" mësimore);
- sipas nevojave të aktiviteteve të planifikuara, t'i organizojnë nxënësit në çifte ose ekipe të përziera etnike/gjuhësore të cilët së bashku duhet të kryejnë detyrë të përcaktuara;
- prezantimi i produkteve nga orët e lira të bëhet në mënyrë bilinguale, me pjesëmarrje të nxënësve nga gjuhë të ndryshme mësimore dhe të gjitha materialet të përgatiten në mënyrë bilinguale;
- gjatë prezantimit eventual të produkteve nga orët e përbashkëta, ftesat dhe katalogu i ekspozitës si dhe tekstet nën fotografi t'i shkruajnë në të gjitha gjuhët mësimore të përfaqsuara në shkollat partnere, dhe
- nëse ka ekspozitë të organizojnë, gjatë kohës së ekspozitës çifte ose grupe të nxënësve të qëndrojnë afër veprës së tyre dhe t'u sqarojnë vizitorëve në gjuhën në të cilën u drejtohen vizitorët.

#### MËSIMI PRAKTIK NË SHKOLLAT PROFESIONALE

Gjatë organizimit të mësimit praktik, mësimitdhënësit përgjegjës në lëndët profesionale/ në mësimin praktik janë të obliguar t'i ndjekin Drejtimet për programim, organizim dhe realizim të trajnimit praktik

në shkollat profesionale të arsimit katërvjeçarë, të përgatitura nga Qendra për arsim dhe trajnim profesional.

Gjatë kësaj, trajnimi praktik mund të realizohet edhe në grupe të vogla ( ekipe) të përbëra prej nxënësve që e ndjekin mësimin në gjuhë të ndryshme të përfaqsuara, pavarësisht nga ajo se trajnimi i tillë do të realizohet **në shkollë** ose **në ndonjë kompani**.

Nxënësit i presin/ udhëheqin dy mësimitdhënës në mësimin praktik të cilët i mbulojnë gjuhët e ndryshme mësimore dhe së bashku e realizojnë mësimin praktik.

Gjatë zgjedhjes së vendit/vendeve për realizimin e praktikës, shkolla duhet t'u japë përparësi atyre ndërmarjeve/ kompanive të cilat përmes kuadrit të tyre i mbulojnë të dy/tre gjuhët mësimore të shkollës.

Nga mësimitdhënësit e mësimit praktik/ mentorët në kompanitë që e realizojnë mësimin praktik në të dy gjuhët pritet:

- së bashku ta planifikojnë mësimin praktik;
- të mbajnë llogari që me tempo të njëjtë t'i realizojnë orët e parashikuara me grupe homogjene të nxënësve që të mund në to të ndërliken orët me grupe të përziera;
- gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të flasin në gjuhët të cilat janë gjuhë mësimore në shkollë dhe të dy/tre gjuhët në mënyrë të barabartë të përfaqsohen në udhëheqjen e aktiviteteve;
- të dy gjuhët të përdoren në mënyrë reciproke (njëra gjuhë të mos shërbejë vetëm për përkthim)

„Në përputhje me programin mësimor dhe numrit nxënësve, mësimit praktik mund të realizohet me tërë paralelen ose paralelja të ndahet në grupe.”

(Nga Drejtimet për programim, organizim dhe realizim të trajnimit praktik në shkollat me arsim profesional katërvjeçarë)

- t'u drejtohen dhe në mënyrë aktive t'i dëgjojnë nxënësit nga grupi gjuhësor i ndryshëm dhe në mënyra të ndryshme të përpiqen sa është e mundur më shumë ta kuptojnë atë që është thënë, dhe
- mentorët duhet të bashkëpunojnë dhe të plotësohen në mes veti gjatë kohës së udhëheqjes së aktiviteteve.

Kur mësimi praktik realizohet në ndërmarje/kompani atëherë pritjet e lartpërmendura kanë të bëjnë me mentorët e organizatave ku mbahet mësimi praktik, dhe ata ua bartin mësimdhënësit e mësimi praktik të mësimi nga shkolla formojnë çifte/treshe të përziera të nxënësve të cilët pastaj së bashku duhet të sigurojnë organizatë në të cilën do ta realizojnë praktikën.

## 4. Drejtimet për shkollat njëgjuhëshe

### 4.1. Realizimi i aktiviteteve të përbashkëta afatshkurtëra

#### EKSKURSIONET DHE PIKNIQET

Shkollat partnere të cilat janë të lokalizuara në komunën e njejtë ( ose në komunat fqinje, në një distancë më të vogël në mes veti, mund të organizojnë ekskursion të përbashkët me të principe të njejtë me të cilat organizohen ekskursionet për shkollat më mësim në dy/tre gjuhë mësimore. Nxënësit nga Klasat e ulta, Bashkësitë e shkollës dhe mësimdhënësit nga dy shkollat mund t'i bëjnë dakordimet të cilat i paraprijnë ngjarjes ballë-për-ballë në mënyrë reciproke në njërën pastaj në shkollën tjetër, ose në formë të komunikimit elektronik ( Yahoo group, Google doc, Skype, Facebook).

Edhe shkollat partnere të cilat janë të locuara në distancë më të madhe njëra nga tjetra ( në komuna të ndryshme), mund të organizojnë ekskursion të përbashkët.<sup>8</sup> Mirëpo, komunikimi për dakordim në mes nxënësve dhe mësimdhënësve mund të realizohet vetëm përmes formës elektronike (Yahoo group, Google doc, Skype, Facebook).

Aktiviteti i parë që duhet të vijojë pas arritjes së nxënësve në vendin e ngjarjes duhet të jetë njohja në mes veti nëpërmjet aktiviteteve me lojë dhe rezimimit të përbashkët të rregullave për sjellje.

#### Përgatitja

Mësimdhënësit përgjegjës nga shkollat partnere bashkëpunojnë në përgatitjen e ekskursioneve dhe pikniqeve si aktivitet i përbashkët. Prej tyre , si ekip, pritet:

- qysh para realizimit të ekskursionit/piknikut / me nxënësit t'i diskutojnë qëllimet e ngjarjes, duke theksuar rëndësinë e njohjes së ndërsjellë dhe shoqërimit me nxënës të shkollës partnere në kontekstin jashtë shkollor;
- të sigurojnë që vendet të cilat do të vizitohen të jenë të rëndësishme për bashkësitë e ndryshme etnike ose ta pasqyrojnë karakterin multi-etnik të rajonit/vendit;
- në mënyrë të njejtë të jenë të përgatitur që t'i sqarojnë dhe prezantojnë vendet e ndryshme të rëndësishme për bashkësitë e kyçura etnike;
- të sigurojnë përkthim të sqarimeve për vendet e vizituara, të pyetjeve dhe përgjigjeve, dhe
- nëqoftë se kërkojnë prej nxënësve që të bëjnë projekte/przetime për ekskursionet/ pikniqet/vizitën, përgatitjen ta bëjnë edhe për vendët e vizituara të rëndësishme për bashkësinë/të "tjetër/tjera" etnike ose për ngajshmëritë në mes lokaliteteve të ndryshme të vizituara.

Në shkollat në të cilat përfaqsimi i nxënësve Rom është i konsiderueshëm, ndërsa pa Rom në kuadrin arsimor, gjatë zgjedhjes së vendeve për vizitë marrin pjesë edhe prindërit Rom të përfshirë në Këshillin e e prindërve për të siguruar përfaqsim të bashkësisë romë në të njejtën dritë pozitive dhe vlerë kulturore sa edhe të bashkësisë etnike të cilës i përkasin shumica e nxënësve tjerë të asaj shkolle.

Prindërit Rom të përfshirë në Këshillin e prindërve , së bashku me nxënësit Rom, marrin pjesë në zgjedhjen e mujikës të cilës do ti ekspozohen nxënësit.

Deri sa udhëtojnë me autobus, si dhe gjatë vendosjes në hotel/pushimore, i kushtohet vëmendje që nxënësit nga grupe të ndryshme nga këto shkolla të mos të grupohen ose mos të ndahen njëri nga tjetri.

Nga mësimdhënësit pritet, që përmes inkurajimit dhe animacionit, të sigurojnë pjesëmarrje të nxënësve Rom në të gjitha aktivitetet në kohën e lirë, së bashku me nxënësit tjerë. Me këtë rast, në veçanti i kushtohet kujdes që në aktivitetet e ndryshme sociale të mos vendosen nxënësit (ose nxënësit jo-Rom) në role stereotipe, ose në situata të cilat janë nën-muese për Romë.

<sup>8</sup>Në arsimin fillorë organizimi bëhet në përputhje me Rregulloren dhe mënyrën e realizimit të ekskursioneve dhe aktiviteteve të lira të nxënësve nga shkollat fillore, 2010



Nga nxënësit pritet:

- përmes Kryetarëve/Zëvendës kryetarëve të bashkësive të klasave nga viti përkatës të marrin pjesë në dhënien e propozimeve për ate se “ka do të vizitohet duke marrë parasysh karakteri multikulturor të rajonit/vendit.

Këshilli i prindërve me përbërje të përzier etnike bashkëpunon në përgatitjen e aktivitetit. Prej tyre, si ekip, pritet:

- të marrin pjesë në dhënien e propozimeve për ate se çka do të vizitohet, duke e marrë parasysh karakterin multietnik të rajonit/vendit.

### **Organizimi i udhëtimit dhe qëndrimit, ushqimit, mbrëmjet shoqërore/zbavitëse**

Mësimdhënësit përgjegjës nga shkollat partnere bashkëpunojnë në mes veti me qëllim:

- të sigurojnë muzikë e cila do të lëshohet gjatë udhëtimit dhe në mbrëmjet shoqërore/zbavitëse të mos jetë nënçmuese për cilëndo bashkësi etnikë/gjuhësore/kulturo;
- muzika e cila do të lëshohet në situata të shoqërimit/zbavitjes të mos favorizojë një bashkësi etnike në llogari të bashkësisë tjetër etnike;
- t’i angazhojnë Kryesitë e Bashkësive shkollore të shkollave partnere të bëjnë zgjedhje të muzikës e cila do të lëshohe, dhe
- të sigurojnë që ushqimi që do u ofrohet nxënësve t’i kënaqë preferencat dietale të nxënësve nga kultura të ndryshme dhe nga restorani të kërkohet që të ofrohet ose ushqim i njejtë për të gjithë, ose të ketë zgjedhje prej dy ushqimesh për të gjithë.

### **Koha e lirë**

Nga mësimdhënësit e shkollave partnere pritet që bashkërisht:

- ta strukturjnë kohën e lirë dhe të ofrojnë aktivitete në të cilat do të marrin pjesë edhe vet mësimdhënësit, dhe
- gjatë organizimit eventual të maskenballit, të kenë kujdes që asnjëra nga maskat të mos jetë nënçmuese ose ofenduese për cilëndo bashkësi etnike.

### **GOSTITË DHE VIYITAT E NDËRSJELLA**

Është mirë që shkolla të inkurajojë gostisje të personave nga përkatësia e ndryshme etnike. Me këtë rast, i kushtohet kujdes sa vijon:

- në shkollë të ftohen të gostisin persona të dalluar nga bashkësia me përkatësi të ndryshme etnike;
- në shkollë të ftohen të gostisin grupe dhe mësimdhënës nga shkolla me mësim në gjuhë të ndryshme prej asaj që zhvillohet mësimi në shkollën-nikoqir, dhe
- për misafirët të cilët flasin në gjuhë të ndryshme nga ajo në të cilën zhvillohet mësimi, shkolla të ofrojë dhe të sigurojë përkthim.

~~~~~  
Në shkolla më përfaqsim të konsiderueshëm të nxënësve Rom, ftohen të gostisin persona të dalluar nga bashkësia rome, me ç’rast kihet kujdes që në publik të ketë nxënës Rom dhe jo-Rom.  
~~~~~

Mësimdhënësit përgjegjës nga shkollat partnere bashkëpunojnë në përgatitjen e vizitave të ndërsjella si aktivitet të përbashkët. Prej tyre, si ekip, pritet:

- të organizojnë vizita të ndërsjella të cilat kanë më shumë se karakter formal ( të cilat nuk mbeten vetëm në nivelin e vizitave të ndërsjella të delegacioneve dy/tre antarëshe për patronat)
- të organizojnë këmbim të nxënësve ( dhe mësimdhënësve) me ç’rast mësimdhënësit nga shkollat partnere përgatisin program të përbashkët edukativ të qëndrimit, e organizojnë jetën sociale dhe sigurojnë vendosje në shtëpi të nxënësve “ nikoqir”;
- të organizojnë paraprakisht njohje të ndërsjellë të fëmijëve me ndërmjetësim të komunikimit elektronik përmes aktiviteteve nga më të ndryshmet, si për shembull: “letërnjoftim” i fëmijëve, i shkollës, i qytetit/fshatit, ose plotësimin e formularit të caktuar me pyetje për qytetin/fshatin dhe simbolet kulturore, ose për kulturën e grupit të caktuar etnik, ose pyetje personale për nxënësin, përgjigjet e të cilit pastaj i prezentojnë në shkollën e tyre.

## SHFAQJE DHE MANIFESTIME

Gjatë përpilimit të programit për shfaqje dhe manifestime me raste të ndryshme, shkolla duhet të ketë kujdes ajo ta reflektojë karakterin multikulturor të vendit dhe të promovojë integrim ndëretnik në arsim. Gjatë kësaj mësimdhënësit përgjegjës duhet të kenë kujdes:

- të paraqesin përmbajtje të cilat kanë të bëjnë me grupet e ndryshme etnike që jetojnë në R.Maqedonisë dhe ta shprehin karakterin multikulturorë të vendit;
- të paraqesin pika të cilat janë karakteristike për grupet etnike/kulturore/gjuhësore të ndryshme nga ajo në të cilën zhvillohet mësimi ( këngë në gjuhën turke, valle shqipe...);
- të ftojnë misafirë nga bashkësia prej grupeve të ndryshme etnike dhe paraprakisht të parashikojnë ku do të ulen që të mos ketë grupim në baza etnike/gjuhësore, dhe
- të ketë pika përmes të cilave do të sigurohet dukshmëria e aktiviteteve multikulturore të cilat realizohen në shkollë.

Shkollat partnere mund të sigurojnë:

- **prezenca personale** në shfaqjet, duke prezentuar me pikë të veçantë, specifike për kulturën e tyre dhe/ose në pikë të përbashkët me nxënësit e shkollës- nikoqir ( e cila do të realizohet në një gjuhë ose në dy gjuhë, në gjuhë tjetër ose pa përdorimin e gjuhëve) dhe/ose në pikë të veçantë për nder të festës së shkollës- nikoqir me theks të ngajshmërive me pandanin e asaj feste në kulturën e tyre;
- **e-prezenca** në shfaqjet përmes dërgimit të xhirimeve ( audio, video) nga paraqitja/aktivitetet e tyre, krijime personale në versionin elektronik, pjesmarrie në shfaqje me anë të lidhjes video konferenciale etj. dhe
- **produkt-prezenca** përmes dërgesës së vizatimeve,përpunimeve, produkteve përmes postës të cilat pastaj do të përdoren në shfaqje.

Në shkollat me mësim në një gjuhë mësimore me përfaqsim të konsiderueshëm të nxënësve Rom, gjatë përpilimit të programit duhet patur kujdes:

- të ketë pika programore të cilat kanë të bëjnë me bashkësinë romë me vëllim dhe cilësi të njejtë sikurse për bashkësinë tjetër etnike;
- në të gjitha pikat të marrin pjesë nxënës që i përkasin grupeve tjera etnike/kulturore pa marrë parasysh nëse përmbajtja/gjuha ka të bëjë me vetëm me njërin grup etnik/gjuhësorë/kulturor ( p.sh., kor i përbërë nga nxënës me përkatësi të ndryshme gjuhësore/etnike/kulturore, i cili në mënyrë reciproke këndon një këngë në një gjuhë dhe një këngë në gjuhën tjetër, seksioni i valleve nga nxënës me përbërje të përzier i cili vallzon në mënyrë reciproke një valle karakteristike për njërin grup etnik dhe një valle që është karakteristike për grupin tjetër etnik).

## ZBAVITJET PËR NXËNËSIT E SHKOLLAVE PARTNERE

Shkollat partnere mund të organizohen zbatimje të përbashkëta për raste të ndryshme ( zbatimjet humanitare zbatimjet për Vitin e Ri,

zbatimjet për manifestime të ditëve të rëndësishme internacionale, si për shembull: Dita e paqës, dita e të rinisë, dita e pranverës). Nëqoftë se në mes nxënësve dhe mësimdhënësve nga shkollat partnere me mësim në gjuhë të ndryshme mësimore nuk kanë ekzistuar më parë kurfarë kontaktesh, atëherë nuk preferohen zbatimje të përbashkëta, ndërkaq nëse këto kontakte kanë ekzistuar, mund të ndiqen rekomandimet të dhëna më poshtë.

### Ygjedhja e vendit

Prej organeve të nxënësve nga shkollat partnere pritet të japin propozime për vende ku mundet të organizohen zbatimje dhe gjatë kësaj i kushtohet kujdes që qyteti/lokali të jenë në mjedis të përyer etnike në të

Në shkollat me një gjuhë mësimore në të cilën është prapë përfaqsimi i konsiderueshëm i nxënësve Rom, gjatë organizimit të zbatimjeve në shkollë duhet posaçërisht të kihet kujdes që të sigurohen kushte të cilat do të mundësojnë që edhe nxënësit Rom të marrin pjesë në mënyrë komode.

Kur bëhet fjalë për zbatimje më serioze nga tipi manifestimeve maturanteske dhe gjysëmaturanteske, përfaqësuesit e bashkësisë romë në organet e nxënësve dhe Këshilli i prindërve duhet të jenë të konsultuar për vendin/lokalin e mbajtjes së zbatimjes, si dhe për menynë e restorantit dhe për repertoarin muzikor zbatimës.



### AKCIONET EKOLOGJIKE

Akcionet ekologjike në të cilat marrin pjesë nxënës nga shkollat partnere duhet të jenë të përbashkëta – të realizohen me nxënës në grupe të përziera etnike/gjuhësore, të koordinuara nga ana e ekipit të përzier etnik/gjuhësor të mësimdhënësve nga të dy shkollat partnere.

Mësimdhënësit përgjegjës të shkollave partnere marrin pjesë në përgatitjen dhe realizimin e ngjarjeve në komunë. Prej tyre pritët:

- para fillimit të akcionit të përcaktojnë nxënës dhe mësimdhënës të cilët do të marrin pjesë në akcionin dhe të formojnë ekupe me përbërje të përzier etnike;
- së bashku me ekipet e përziera nga nxënës të përgatiten për akcionin (përmes komunikimit ball-për-ballë, ose përmes komunikimit elektronik me ndërmjetësim kompjuterik), t'i këmbëjnë idetë dhe propozimet, të dakordohen për kohën, vendin dhe mënyrën e realizimit të të njetës, dhe së bashku të marrin pjesë në akcionin ekologjik;
- nëse akcioni përbëhet prej më shumë aktiviteteve të ndryshme, punën e nxënësve ta organizojnë në grupe të vogla në përbërje të përzier, dhe
- të gjitha parullat, pllakatet, transparentet t'i përgatisin në gjuhët mësimore të shkollave partnere.

### NGJARJE NË KOMUNË

Nxënësit e shkollave partnere nga komuna e njetë duhet të jenë të inkurajuar të marrin pjesë në ngjarje nga më të ndryshmet të cilat organizohen në bashkësi, siç janë për shembull: manifestimi i Ditës së komunës, pjesëmarrja në ekspozita shitëse dhe hepeningje, pjesëmarrja në debate, tribuna, pjesëmarrja në kampanjë

për ngritjen e vetëdijes publike për probleme të ndryshme sociale etj. “do angazhman i tillë i nxënësve duhet të jetë i përbashkët – të realizohet nga grupi i nxënësve – prezantues të shkollave partnere, me përbërje të përzier etnike/gjuhësorë.

Mësimdhënësit përgjegjës të shkollave partnere marrin pjesë në përgatitjen dhe realizimin e ngjarjeve në komunë. Prej tyre pritët:

- t'i shqyrtojnë të gjitha ftesat për përfshirjen e shkollës në ngjarje për bashkësinë dhe, mbi bazën e vlersimit të bërë në raport me atë se sa mundësojnë promovim të multikulturës, t'i informojnë nxënësit dhe mësimdhënësit nga shkollat partnere;
- shkollat partnere në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me shkollat tjera të inkurajojnë dhe iniciojnë ngjarje të ndryshme për bashkësinë përmes së cilës nxënësve dhe mësimdhënësve do t'u mundësojnë që të participojnë në mënyrë aktive në bashkësi, duke demonstruar modelin e jetesës multikulturore/multi-etnike;
- ekipet e përziera nga nxënës dhe mësimdhënës nga shkollat partnere bashkërisht të përgatitën për akcion (përmes komunikimit ballë-për-ballë, ose përmes komunikimit të ndërmjetësuar elektronik), t'i këmbëjnë idetë dhe propozimet, të dakordohen për kohën, vendin dhe mënyrën e realizimit të të njetës, dhe së bashku të marrin pjesë në te, dhe
- të sigurojnë që raportet nga aktivitetet të vendosen të shkruara në të dy/tre gjuhë mësimore.

Nga nxënësit të cilët janë antarë të organit përkatës të nxënësve në të dy shkollat partnere mund të pritët:

- të marrin pjesë në përgatitjen e programit për përfaqsim të shkollave në ngjarjet në bashkësinë me propozimet dhe sygjerimet e veta, dhe
- të mos pranojnë të marrin pjesë në ngjarje në bashkësi të cilat nuk e promovojnë komunën si mjedis multikulturore/multi-etnik.

„Aktivitetet dhe bashkëpunimi me mjedisin lokal të cilat i përmban programi për punë i shkollës fillore mbështeten me mjete përkatëse financiare, ndërsa, përmbajtjet, lloji dhe mënyra e bashkëpunimit me mjedisin lokal përcaktohet me programin për punë të shkollës për secili vit mësimorë.“

(Nga Koncepti për edukim dhe arsim nëntëvjë”ar, shkurt. 2007., fq.114)

## 4.2. Realizimi i aktiviteteve të përbashkëta më afatgjate

„Multikulturaliteti në shoqërinë maqedonase kërkon që shkolla fillore të promovojë zhvillimin e vlerave tek nxënësit për jetë të përbashkët, respektim të dallimeve në mes njerëzve dhe kulturës të tyre, gjuhës dhe traditave. Shkolla është përgjegjëse për zhvillimin e vetëdijes të nxënësit për prejardhjen kulturore të tyre, dhe gjithashtu edhe për inkurajimin e interesimit për njohjen e trashëgimisë kulturore të bashkësive tjera etnike.“

(Nga Koncepti për edukim dhe arsim fillorë nëntëvjeçarë, shkurt. viti 2007., fq 74)

### PUNËTORI MULTIKULTURORE

Shkollat partnere me gjuhë të ndryshme mësimore nga komuna të njeta apo të ndryshme të cilat ndodhen **afër njëra tjetrës**, mund të realizojnë punëtori multikulturore në mënyrë të njëjtë sikurse shkollat me mësim në dy/tre gjuhë mësimore, me atë që duhet të sigurojnë transportimin e nxënësve nga njëra në tjetren shkollë, për secilën punëtori reciprokisht. Punëtoritë multikulturore janë një varg i aktiviteteve jashtëmësimore të cilat realizohen në formën e seksioneve dy gjuhësore me nxënës dhe mësimdhënës në përbërje të përzier etnike/gjuhësore. Këto punëtori i udhëheqin nga dy mësimdhënës nga gjuhë të ndryshme mësimore dhe në to, me dëshirë të tyre, merr pjesë numër i balancuar i nxënësve nga grupe të ndryshme etnike ( nga gjuhë të ndryshme mësimore) dhe nga të dy gjinitë. Nxënësit në këto punëtori takohen më së paku një herë në javë dhe punëtoritë zgjasin më së paku një gjysëmvetor.

### Përgatitja

- në shkollë të formohet katër çifte mësimdhënës ( për shkolla fillore), respektivisht dy çifte mësimdhënës ( për shkolla të mesme)
- çiftet e mësimdhënësve nga shkolla të marrin pjesë në stërvitje tre ditore për realizimin e punëtorive multikulturore<sup>9</sup>;
- secili nga çiftet duhet të udhëheqë nga një grup madhor ( të përbërë nga nxënës prej dy ose tre viteve mësimore ) nxënës dhe me to gjatë një gjysëmvetori të realizohet punëtori multikulturore;
- çiftet mësimdhënës ta realizojnë programin e përgatitur paraprakisht sipas Doracakut për punëtori multikulturore<sup>10</sup>;
- çiftet mësimdhënës në mënzrë themeltare të përgatiten për secilën punëtori, ndërsa përgatitja përfshin përgatitjen e materialeve dhe përgatitjen për udhëheqje dy gjuhëshe të punëtorisë;
- Mësimdhënësit të zgjedhin nxënës për pjesëmarrje në punëtoritë multikulturore sipas kriteriumeve të përcaktuara paraprakisht për numrin dhe gjininë e nxënësve nga klasë të ndryshme.
- mësimdhënësit në mbledhjet prindore t'i informojnë prindërit për punëtoritë dhe të sigurojnë pëlqim me shkrim për pjesëmarrjen e fëmijëve të tyre dhe

<sup>9</sup>Stërvitja e mësimdhënësve për realizimin e punëtorive multikulturore është me karakter punues dhe përfshin mësim të përvijshëm, të ndjekur me diskutime për bazat teorike ( sigurim i tretmanit të barabartë, dygjuhësi, metoda të punës etj. ), si dhe pjesën praktike në të cilin mësimdhënësit përgatisin dhe realizojnë pjesë nga punëtoritë multikulturore nën observimin e trajnuesëve.

<sup>10</sup>Punëtoritë multikulturore janë të përgatitur nga ana e Qendrës për të drejtat e njeriut dhe zgjidhjen e konflikteve, në kuadër të projektit “Shkolla sipas masës së fëmijës” të cilën e financoi UNICEF, ndërsa u realizua në bashkëpunim me Ministrinë e arsimit dhe shkencës dhe Bironë për zhvillimin e arsimit. Për nevojat e këtij programi janë përgatitur doracake të veçantë ( njëri për shkollat fillore dhe një pjesë e tij për shkolla të mesme) në gjuhën maqedonishte, shqipe dhe turqishte, të dedikuara për mësimdhënësit – realizatorë të punëtorive.

- përmes lajmërimit me shkrim të vendosur në vende të theksuara, mësime të realizatorëve t'i informojnë pjesëmarrësit për kohën e mbajtjes të puntorive multikulturore, e cila duhet të përcaktohet në atë mënyrë që të mund t'u konvenojë nxënësve të shkollave partnere.

### Realizimi

- mësime të realizatorëve i realizojnë aktivitetet të organizuara në formë dygjuhëshe, përmes metodës së parafrazimit dhe plotësimit<sup>11</sup>;
- të gjitha aktivitetet udhëhiqen në dy gjuhë, përmes metodës së parafrazimit dhe plotësimit;
- mësime të realizatorëve – realizatorëve i realizojnë punëtoritë me radhë, pa kërcime, ndërsa me mundësi për shtuar punëtoritë të reja me miratimin paraprak nga ana e ekipit profesional,
- në fund të realizimit të punëtorive, mësime të bashkuar me pjesëmarrësit përgatisin manifestim qëllimi is ë cilës është të sigurojë dukshmërinë dhe promovimin e produkteve të përbashkëta të punuara në punëtori ( gjatë organizimit të manifestimit përfundimtarë ndiqen drejtimet për shfaqje dhe manifestime).

Në shkolla me përfaqsim të konsiderueshëm të nxënësve Rom, mund të realizohen edhe punëtori multikulturore me fëmijë të cilët nuk janë Rom dhe ata në dy raste:

1. Kur nxënësit Rom dhe ata që nuk janë Rom mësojnë në gjuhë të **njejtë** mësimore, punëtoritë multikulturore i udhëheqin dy mësime nga e njëjta gjuhë mësimore dhe realizohen në dy gjuhë.
2. Nxënësit Rom nga shkolla me një gjuhë mësimore mund të marrin pjesë në punëtori multikulturore me nxënës nga shkolla partnere që mësojnë në gjuhë **tjetër**. Me këtë rast, punëtoritë i udhëheqin dy mësime nga gjuhë të ndryshme mësimore dhe realizohen në dy gjuhë.

Me rëndësi të veçantë është që të sigurohet edhe realizator Rom, dhe nëse në shkollë nuk ka mësime Rom, mirë është që në rolin e asistentit të mësime të realizatorëve ( mund të jetë prind, anëtar i ndonjë organizate jo qeveritare, student- praktikant ose vulnetarë nga bashkësia përkatëse).

### TIK PUNËTORI MULTIKULTURORE

Shkollat partnere me gjuhë të ndryshme mësimore nga komuna të njëjta ose të ndryshme, e të cilat ndodhen **larg njëra tjetrës**, mund të zbatojnë kombinim të punëtorive multikulturore të cilat realizohen **“ballë-për-ballë”** edhe me **komunikim të ndërmjetësuar me kompjuterë**.

TIK punëtoritë multikulturore janë punëtori të cilat janë të përshtatura për zbatim me ndihmën e komunikimit të ndërmjetësuar kompjuterik. Ato janë punëtoritë e njëjta multikulturore të përkrahura më parë, me ç'rast për një pjesë të tyre janë të punuara versione elektronike të fletëve punuese dhe mund të realizohen me ndihmën internet lidhjes. Për përgatitjen dhe realizimin e TIK punëtorive multikulturore vlejnjë drejtimet bazike sikurse edhe për zbatimin e punëtorive “ballë –për- ballë” ( të dhëna më lartë), por edhe disa plotësuese të cilat dalin nga shfrytëzimi i mediumit specifik. Komunikimi me ndërmjetësim kompjuterik nuk mundët në tërësi ta zvendësojë komunikimin e drejtpërdrejtë, për këtë shkak zbatimi i TIK punëtorive multikulturore në esencë paraqet kombinim të realizimit të punëtorive “fëtyrë-për fëtyrë” të cilat realizohen me ndihmën e kompjuterëve dhe zhvillohet në disa faza::

#### 1. faza: “ballë-për-ballë” (punëtori hyrëse)

Jashtë nga shkollat partnere, në hapësira të komunës ose në ndonjë vend tjetër realizohet takim njëditorë. Në këtë takim të gjithë nxënësit-pjesëmarrës në punëtoritë multikulturore së bashku me mësime të realizatorëve nga shkollat partnere, të ndarë në grupe me moshë përkatëse, i realizojnë tre punëtoritë e para multikulturore hyrëse. Në kohën e lirë mësime të realizatorëve mund të organizojnë aktivitete sociale ( shoqërore sportive) me qëllim që nxënësit dhe mësime të njihen më mirë në mes veti dhe të realizojnë lidhje më të thella të cilat do të jenë bazë për komunikim të mëtejshëm të ndërmjetësuar.

<sup>11</sup> Struktura e punëtorive multikulturore e ndjek strukturën e punëtorive për Arsim për shkathtësi jetësore, të cilat janë të përgatitura në kuadër të projektit “ Shkolla sipas masës së fëmijës” të cilën e financoi UNICEF, ndërsa u realizua në bashkëpunim me Ministrinë e arsimit dhe shkencës dhe Bironë për zhvillimin e arsimit.

## 2. faza: **TIK punëtori** (projekt punëtoritë /e realizuara multikulturore)<sup>12</sup>

Pjesëmarrësit, secili në shkollën e “vet”, me ndihmën e komunikimit të ndërmjetësuar kompjutorik, përmes internet lidhjes dhe me përdorimin e materialeve të parapërgatitura për realizimin e punëtorive, i realizojnë punëtoritë multikulturore që pasojnë. Ato punëtori sipas përmbajtjes dhe qëllimeve të tyre janë të njëjta sikurse edhe punëtoritë që realizohen “ballë-për-ballë”, vetëm se janë të adaptuara për realizimin me ndihmën e TIK (janë të përgatitura fletëza pune përkatëse në Googledos, komunikohet përmes Skype, dhe për ndihmë në përkthimin shfrytëzohet Googletranslate).

## 3. faza: **“ballë-për-ballë”** ( shfaqja përfundimtare)

Projekt punëtoritë/ përfundimtare e realizuar në formën e ngjarjes/shfaqjes së përbashkët nxënës dhe mësimdhënës nga shkollat partnere e realizojnë bashkërisht në hapësirat e komunës ose në ndonjë vend tjetër kun ë prezencë të misafirëve nga të dy shkollat, prindër dhe persona tjerë nga bashkësia, prezentojnë pjesë të punës së tyre.

### AKTIVITETE TË LIRA TË NXËNËVE - SEKSIONET

Seksionet nga shkollat partnere mund të punojnë në njohjen e ndërsjellë dhe në projekte cooperative për thellimin dhe zgjerimin e njohurive, përmes realizimit të:

1. **e-projekte**, me ndihmën e medimeve elektronike – përmes këmbimit, përpunimit dhe plotësimit të materialeve elektronike dhe shkrimeve si dhe prezentimit të tyre në shkolla;
2. **product-projektet**, me ndihmën e e-postës përmes këmbimit, përpunimit dhe plotësimit të materialeve dhe punëve përmes postës dhe prezentimit të tyre në shkolla;
3. **projekte të “drejtpërdrejta”** – përmes aktiviteteve të përbashkëta jashtëmësimore në formë të aktiviteteve që realizohen “ballë-për-ballë” në ekskursionë, pikniqe, vizita të përbashkëta dhe
4. **pjesmarrje e përbashkët dhe bashkëpunim në projekte vendore dhe ndërkombëtare** (nga lëmi i ekologjisë, komunikimit elektronik dhe teknologjisë, sportit...) me ekipe nxënësish dhe mësimdhënës të përziera ( etnike/gjuhësore/kulturore) nga shkollat partnere.

Secili seksion duhet të realizohet sipas planit dhe dinamikës të aktiviteteve të përcaktuara paraprakisht me kohëzgjatje prej më së paku një gjysëmvetor. Shpesh herë, secili nga llojet e veçanta të projekteve në vete përmban edhe elemente nga të tjerët të cilat duhet të merren parasysh gjatë planifikimit të aktiviteteve konkrete.

Bashkëpunimi në mes mësimdhënësve-udhëheqë të seksioneve nga shkollat partnere është kyç për realizim të suksesshëm të projekteve të tilla. Prej tyre, si ekip, pritet:

- të përgatisin disa tema për projekte për të cilat mendojnë se janë më adekuate për realizim për të dy shkollat partnere;
- t’u ofrojnë nxënësve ( secili në shkollën e vet) disa tema për projekte dhe bashkërisht me nxënësit ( me votim) ta zgjedhin temën për punë të seksionit;
- të përpilojnë plan të përbashkët për punë;
- të kenë komunikim të vazhdueshëm në mes veti;
- të ndihmojnë në sigurimin e përkthimit;

<sup>12</sup>Për realizimin e TIK punëtorive mësimdhënës-realizatorë, përveç stërvitjes dhe materialeve si për zbatimin e punëtorive multikulturore që realizohen për zbatimin e punëtorive multikulturore “fëtyrë-për fëtyrë”, është e nevojshme që të marrin stërvitje plotësuese për përdorimin e fletëzave punuese elektronike dhe të disponojnë me kompjutorë me internet lidhje të pandërprerë, të pajisura me kamerë, autoparlantë dhe mikrofonë.

- t'i bartin informatat deri tek nxënësit dhe anasjelltas.
- t'i trajtojnë me respekt materialet e marra nga shkolla tjetër dhe të dekurajojnë çfardo lloj nënçmimi, zhvlerësimi ose përqeshje në grupin e "vet" në llogari të kualitetit të produkteve të fituara, gjuhës ose informative që gjenden në to.

Në kuadër të secilës shkollë mund të këtë seksione të cilat nuk janë të përbashkëta me nxënës të shkollave partnere, ndërsa mësimdhënësit nga shkollat partnere të cilët i udhëheqin mund të bashkëpunojë në mes veti në sigurimin e mënyrës përkatëse të organizimit dhe realizimit të tyre përmes së cilës do ta reflektojnë dhe promovojnë integrimin multi-etnik dhe multikulturorë në arsim. Gjatë realizimit të seksioneve të tilla mësimdhënësit duhet të sigurojnë:

- pjesë të materialeve për thellimin e njohurive të nxënësve për ta ilustruar karakterin multi-etnik të vendit ( për shembull, seksioni i artit figurative të ketë tema të cilat kanë të bëjnë me multikulturën, prezente të veprave nga autorë të artit figurative nga grupe të ndryshme etnike, pjesë nga tekste të fliten në ndonjëerë prej gjuhëve të bashkësisë së caktuar etnike që është i ndryshme nga gjuha me të cilën zhvillohet mësimi në shkollë...), dhe
- gjatë zgjedhjes së përmbajtjeve të cilat do të punohen, detyrimisht të këtë konsultime me mësimdhënësit nga gjuha tjetër mësimore nga shkolla partnere që t'i njohin perspektivat e grupit tjetër etnik/kulturor/gjuhësor mbi përmbajtjen dhe të marrin vlerësim për korektësinë e sajë.

#### **Shembull për e-projekte: Zakonet me rastin e lindjes së fëmijëve**

Nxënësit nga seksioni i gjeografisë/historisë nga shkollat partnere me mësim në dhuhë të ndryshme mund t'i hulumtojnë yakonet me rastin e lindjes së fëmijëve nga rrethina e tyre, duke udhëhequr intervistë dhe duke xhiruar tregimet e njerëzve. Pastaj mund t'ji dërgojnë xhirimet me postë elektronike dhe të bëjnë analizë të përbashkët për ngjajshmëritë dhe dallimet. Në fund, mund të bëjnë prezente të përbashkët online në ueb faqet e shkollave të tyre ose përmes akcioneve për mbledhjen e mjeteve të sigurojnë materiale dhe shërbime për shtypjen e broshurës të cilën do ta promovojnë bashkërisht.

#### **Shembull për produkt-projektin: Projekt gjethi**

Pjesëmarrësit e seksionit figurativ dhe natyrore-shkencor nag të dy shkollat partnere mund bashkërisht të përpunojnë vizatime nga gjethet vjeshtore. Nxënësit nga njëra shkollë mbledhin gjethë vjeshtore nga rrethina e tyre ( me numër çift për secilin lloj gjethi, e më së paku nga dy), i thajnë, i presojnë, e ngjesin në fletë në të cilën e shkruajnë emrin e drurit, frytën që e jep ai dru, përdorimi i tij dhe e ruajnë secilin në foli të veçantë. Pastaj nga një gjeth nga lloji i njëjtë e mbajnë për vete, ndërsa tjetrin e dërgojnë në shkollën tjetër ( ose me postë ose e fotografojnë, dhe fotografinë e dërgojnë me e-mail). Kështu shkollat në fund kanë gjethë të njeta nga të dy rrethinat dhe secili seksion përpunon sipas dëshirës së vet vizatime në të cilat i ngjesin gjethet dhe i vizatojnë. Në fund organizojnë ekspozitë të vizatimeve dhe i prezentojnë punët që i kanë mësuar për drunjtë që rriten në rrethinën e shkollës partnere. Ekspozita mund të organizohet bashkërisht ( me gostisje të njëjës shkollë tek shkolla tjetër ose prezente të përbashkët në hapësirë tjetër në ndonjë Shoqatë joqeveritare ose në komunë) ose në mënyrë të pavarur ( secili seksion në shkollën e tij) ndërsa fotografitë nga vizatimet mund të ekspozohen në ueb faqet e shkollave.

#### **Shembulli për projektin "drejtpërsëdrejti" (live) : Livadhi ynë**

Nxënësit nga shkollat partnere mund të organizojnë disa pikniqe të përbashkëta në lokalitetet në natyrë të cilat së bashku do t'i mësojnë ( bota bimore dhe shtazore që jeton në atë eko hapësirë) dhe mbajnë ( pastrimin nga mbeturinat, mbjellja e drunjëve dhe luleve, vendosja e shenjave për ndalesë të dëmtimit të bimëve, vendosja e tabelave informative për lloje të ndryshme të bimëve dhe shtayëve) dhe do të vendosin ushqime për zogj dhe kafshë tjera.



### Shembull për pjesëmarrje në projektin ndërkombëtar : Kënga e përbashkët

Në kuadër të projektit ndërkombëtar për krijimin e **Muzikës botërore**, në të cilin me melodi të njejtë dhe kore nga vende të ndryshme marrin pjesë duke dërguar audio inçizime nga shfaqja në gjuhë të ndryshme, pjesëmarrësit në seksionin e korit nga seksioni i korit të shkollave partnere mund të përgatisin shfaqje të përbashkët përmes shkëmbimit të ndërsjellë të audio xhirimeve nga pjesë të veçanta të këngës të cilën e këndojnë nxënësit në gjuhë të ndryshme mësimore. Më së pari secili kor në gjuhën e vet mësimore e këndon një strofë, pastaj i shkëmbejnë xhirimet dhe secili kor duhet ta mësojë ta këndojë strofën në gjuhën tjetër mësimore, dhe në fund bashkërisht t'i këndojnë edhe strofat e njëjës dhe strofat e tjetrës gjuhë dhe me këtë xhirim bashkërisht të marrin pjesë në projekt.

### AKTIVITETE HUMANITARE NË BASHKËSI

Mësimdhënësit përgjegjës mund të zgjedhin një ose më shumë aktivitete humanitare në bashkësi (ofrimi i ndihmës nxënësve në mësim ose personave të rrezikuar social dhe/ose kujdes për persona të moshuar , shoqërim me fëmijë nga shtëpia e fëmijëve pa prindër, realizimi i akcioneve për mbledhjen dhe distribuimin e ndihmës humanitare në bashkëpunim me Kryqin e Kuq dhe Gjysëmshënën e Kuqe e tjerë) të cilat lypset të zbatohen me nxënës me përbërje të përzier.

Nëqoftë se shkolla në programin e saj ka të definuar paraprakisht se çfarë tip aktivitetesh humanitare do t'i ndërmer gjatë vitit shkollor, mësimdhënësit përgjegjës mund të bëjnë analizë që të vërtetojnë se cilat prej tyre janë më adekuate për realizimin me nxënës me përbërje të përzier etnike/gjuhësore. Nëse shkolla nuk ka parashikuar këso lloj aktivitetesh, mësimdhënësit përgjegjës mund të propozojnë një ose më shumë aktivitete të cilat do të realizoheshin në periudhën prej më së paku një gjysëmvetori.

Në vijim pason shembulli i aktivitetit humanitar në bashkësi, i cili mund të shërbejë si ide dhe/ose si model për për realizimin e aktiviteteve të ngajshme.

### Ndihmë personave të moshuar

Mësimdhënësit përgjegjës nga gjuhë të ndryshme mësimore, së bashku me përfaqësues të Këshillit të prindërve, duhet të hartojnë listën e personave të moshuar ( farefis të nxënësve dhe/ose persona tjerë të moshuar nga rrethina )të cilëve u duhet ndihmë në realizimin e aktiviteteve të përditëshme.

Nxënësit nga përkatësia e ndryshme etnike/gjuhësore, të ndarë në çifte ose grupe, duhet të realizojnë biseda paraprake me persona të moshuar që të zbulojnë se çfarë lloj ndihme u është e nevojshme dhe të njejtat t'i vendosin në listë ( për shembull, furnizimi me mjete për plotësimin e nevojave ditore, leximi i gazetave ditore, komunikimi përmes internetit, lojë me letra, shah...). Pastaj, çiftet/grupet e nxënësve zgjedhin një ose më shumë punë nga lista të cilat do të mund t'i bëjnë dhe e realizojnë aktivitetin që e kanë zgjedhur të gjithë njerëzit e moshuar të cilëve u nevojitet.

## 4.3. Zbatimi i aktiviteteve të përbashkëta mësimore

### PROJEKT AKTIVITETET NË KUADËR TË LËNDËVE TË RREGULLTA

Përmes projekt aktiviteteve në kuadër të lëndëve të rregullta, shkollat partnere mund të punojnë në njohjen e ndërsjellë, zhvillimin e bashkëpunimit, por edhe në thellimin dhe zgjerimin e njohurive, përmes:

- **e-projekteve** me ndihmën e medimeve elektronike-përmes këmbimit, përpunimit dhe plotësimit të materialeve dhe shkrimeve dhe prezentimit të tyre në shkolla;
- **produkt-projekte**, me ndihmën e postës – përmes këmbimit të materialeve përmes postës, përpunimi i tyre dhe plotësimi, e deri te përpunimi i produkteve dhe prezentimi i tyre në shkolla;
- **projekte të drejtpërdrejta ( live)** – përmes aktiviteteve të përbashkëta jashtëshkollore të cilat realizohen “ballë-për-ballë” në ekskursione, pikniqe, vizita të përbashkëta.

## Realizimi

Realizimi i projekt aktiviteteve zhvillohet sipas planit dhe dinamikës së përcaktuar paraprakisht gjatë vitit shkollor të cilat i miratojnë mësimdhënësit përgjegjës nga shkollat partnere. Bashkëpunimi në mes mësimdhënësve të shkollave partnere të cilat janë përgjegjëse për realizimin e projekt aktiviteteve është kyç për zbatim të suksesshëm të projekteve të tilla. Prej tyre, si ekip, pritet:

- në kuadër të lëndëve konkrete të përgatisin disa tema për projekte për të cilat llogaritet se janë më të përshtatshme për realizim dhe për realizimin e së cilave është e nevojshme pjesëmarrja e nxënësve nga dy shkollat partnere;
- në kuadër të lëndëve konkrete, t'u ofrojnë nxënësve ( secili në shkollën e tij) disa tema për projekte dhe së bashku me nxënësit ( me votim) ta zgjedhin temën për punë;
- të përpilojnë plan të përbashkët për punë;
- të jenë në komunikim të përhershëm dhe të realizojnë takime për dakordim;
- të përgatisin aktivitet për njohje të ndërsjellë të nxënësve qysh në takimin e parë të përbashkët;
- të ndihmojnë në sigurimin e përkthimit;
- t'i bartin informatat deri te nxënësit dhe anasjelltas, dhe
- t'i trajtojnë materialet e fituara nga shkolla tjetër me respekt dhe të dekurajojnë çfardo nënçmimi, zhvlersimi dhe përqeshje në grupin e “vet” në llogari të kualitetit teknik të produkteve të fituara, të gjuhës dhe të informative në to.

### Shembuj për aktivitete projektuese në mësimin për art figurativ

#### **Projekt produkti: Përmbarrim i vizatimeve**

Nxënësit nga të dy shkollat partnere, në orë të veçanta mund të kërkojnë vizatime të caktuara përmes teknikave të ndryshme, por t'i lënë të pa mbaruara dhe pastaj përpunimet e tilla t'i këmbejnë me ate që do t'i dërgojnë/ paraqesin deri te shkolla partnere. Pasi që të pranohen vizatimet nga shkolla partnere, nxënësit i përmbarrojnë dhe i ruajnë. Në fund mund të organizohet ekspozitë ( afariste) nga vizatimet/veprat e bëra në të dy shkollat, ose në ndonjë vend të tretë neutral ( shtëpi të kulturës, komunë etj. ).

#### **Projekti “drejtpërsëdrejti” (live)**

Nxënësit nga shkollat partnere mund të organizojnë disa pikniqe në lokalitetet natyrore dhe atje në grupe të vogla të përziera ose në çifte të përziera të punojnë në krijimin e vizatimeve të përbashkëta dhe ate me përdorimin e teknikave të ndryshme. Në fund mund të organizohet ekspozitë ( shitëse) nga vizatimet / veprat e bëra në të dy shkollat, ose në ndonjë vend të tretë neutral ( shtëpia e kulturës, komuna etj. ).

### Shembuj për projekt aktivitete në mësimin e gjuhës angleze

#### **E-projekti: përgatitja e tregjuhësorit**

Nxënësit nga të dy shkollat partnere, secili në shkollën e tij, mbledhin material në gjuhën angleze ( shprehje, fraza, fjalë) të grupuara në tema dhe të njetët i përkthejnë në gjuhën e vet mësimore. Pastaj përmes e-postës u dërgohen nxënësve të shkollës partnere të cilat sigurojnë përkthim të materialit të marrë në gjuhën e (tretë ) të saj, dhe kjo ndodh paralelisht me të dy grupet e nxënësve. Në fund mund të bëjnë prezentim të drejtpërdrejtë (online) të materialit të përgatitur në ueb faqet e shkollave të tyre , ose përmes bashkëpunimit me biznes komunitetin nga komunat e tyre, të sigurojnë mjete për shtypjen e broshurës të cilën së bashku do ta promovojnë.

#### **Projekti “drejtpërsëdrejti” (live): Përgatitja e pikave në gjuhën angleze**

Nxënësit nga shkollat partnere mund të organizojnë disa pikniqe në lokalitete natyrore dhe atje në grupe të vogla të përziera të dakordohen dhe të ushtrojnë pika të përbashkëta (këngë, skeqe, imitime të personaliteteve të njohura) në gjuhën angleze të cilat në fund do t'i prezentonin para të tjerëve. Kështu pikat e përgatitura mund të shfrytëzohen gjatë manifestimeve dhe shfaqjeve në vetë shkollat dhe/ose në komunën/komunat në të cilat janë të locuara shkollat.

### MËSIMI NË NATYRË NË SHKOLLAT FILLORE

Për nxënësit e klasës së IV të cilët mësojnë në gjuhë të ndryshme

mësimore të përfaqsuara në shkollë pritet që mësimi në natyrë të organizohet në kohë të njëjtë dhe në vend të njëjtë. Me këtë rast, orët për lëndët në të cilat mund të realizohen aktivitete praktike ose aktivitete të realizuara duhet të zbatohen në grupe të përziera etnike/gjuhësore: dy paralele nga dy ( ose tre ) gjuhë të ndryshme mësimore bashkohen dhe së bashku i realizojnë përmbajtjet për të cilat nuk nevojitet shumë shprehje gojore, por kërkojnë më shumë punë praktike.

„Në prag të realizimit, e më së voni shtatë ditë para realizimit të ekskursioneve ose aktiviteteve tjera të lira, udhëheqësi i klasës organizon takim me nxënësit dhe prindërit e tyre, me ç'rast i informon dhe u jep sqarime detajuese për programin i cili do të realizohet.“

(Nga Rregullorja për mënyrën e realizimit të ekskursioneve shkolloredhe aktiviteteve tjera të lira të nxënësve të shkollave fillore, neni 25)

#### Përgatitja

Duke u thirur në Rregulloren për mënyrën e realizimit të ekskursioneve shkollore dhe aktiviteteve tjera të lira të nxënësve të shkollave fillore, mësimdhënësit përgjegjës nga të dy shkollat partnere me gjuhë të ndryshme mësimore bashkëpunojnë në përgatitjen e mësimit në natyrë.

#### Përgatitja

Mësimdhënësit përgjegjës me gjuhë të ndryshme mësimore bashkëpunojnë në përgatitjen e mësimit në natyrë. Prej tyre, si ekip, pritet:

- të përgatisin program ( të zgjedhin temë/përmbajtje, të definojnë qëllime dhe të dakordojnë plan pune me detyra konkrete);
- të sigurojnë që Këshillat shkollore nga të dy shkollat partnere ta miratojnë programin mbi bazën e mendimeve të marra nga Biroja për zhvillimin e arsimit, Këshilli i prindërve dhe Këshilli i komunës;
- të mbajnë mbledhje prindore ( në të dy shkollat) në të cilat do t'i njoftojnë prindërit me organizimin e mësimit në natyrë dhe të sigurojnë lejen e tyre ( më së paku 70% nga prindërit e nxënësve në secilën klasë) për realizimin e mësimit të përbashkët në natyrë, dhe
- të përpilojnë listë dygjuhëshe për nocionet kyçe në të cilat do të mund të referohen dhe t'i vënë në lidhshmëri gjatë realizimit të aktiviteteve të përbashkëta të mësimit në natyrë.

#### Realizimi

Nxënësit të cilët mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore, në shoqërim të mësimdhënësve, së bashku të udhëtojnë deri te vendi/ vendet i parashikuar për realizimin e mësimit në natyrë dhe së bashku të kthehen pas përfundimit të tij.

Qysh në fillim të realizimit të aktiviteteve të parashikuara mësimdhënësit, duhet të kenë kujdes në çështjet e parashtruara në vijim:

- gjatë aktivitetit të parë të përbashkët i cili duhet të vijojë pas ardhjes së nxënësve në vendin e ngjarjes duhet të pasojë njohja e ndërsjellë nëpërmjet lojëve aktiviteteve
- të flasim në gjuhën në të cilën e udhëheqin mësimin, por të kenë kujdes që të dy gjuhët të përfaqsohen në mënyrë të barabartë gjatë udhëheqjes së aktiviteteve;
- të dy gjuhët të përdoren në mënyrë të barabartë dhe reciproke ( njëra gjuhë të mos shërbejë vetëm për përkthim);
- t'u drejtohen dhe në mënyrë aktive t'i dëgjojnë nxënësit nga grupi i ndryshëm gjuhësor dhe në mënyra të ndryshme të përpiqen sa është e mundur ta kuptojnë atë çka thuhet;
- të bashkëpunojnë dhe të plotësohen në mes veti gjatë udhëheqjes së aktiviteteve ( për shembull, disa nga nocionet themelore të përgatitura paraprakisht në lidhje me temën të dy mësimdhënësve t'i tregojnë në të dy gjuhët);

- sipas nevojës, të formojnë grupe të vogla dhe ato me nxënës me përkatësi etnike dhe gjinore të përziera dhe në punën grupore t'i inkurajojnë të gjithë nxënësit të bashkëpunojnë në mes veti, pavarësisht përkatësisë së tyre etnike, dhe
- t'i lavdërojnë të gjithë nxënësit, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike.

### **PROJEKT AKTIVITETET NË ARSIM GJIMNAZOR**

Projekt aktivitetet të cilat janë të parashikuara me planin mësimor për arsim gjimnazor mund të organizohen edhe në grupe të përziera nxënësish nga të dy shkollat partnere me gjuhë të ndryshme mësimore. Më rëndësi për aktivitetet e tilla është që nxënësit nga të dy grupet e përfaqësuara gjuhësore të bëjnë diçka që do të përfundojë me produkt të përbashkët, i përpunuar përmes bashkëpunimit reciprok.

Aktivitetet projektuese janë të organizuara jasht mësimin, andaj, mund të zhvillohen edhe në ditët e shtuna si orë të veçanta ose si blok orë. Sipas planit mësimorë për arsim gjimnazor, duhet të realizohen gjithsej 36 orë gjatë një gjysëmvetori.

Mënyra e realizimit të projekt aktivitetëve mund të jetë kombinim nga kontakti direkt (ballë-për-ballë) dhe kontakt i ndërmjetësuar (përmes komunikimit të ndërmjetësuar kompjuterik). Me këtë rast, do të ishte mirë që së paku gjysma e takimeve të pjesëmarrësve të realizohen përmes kontaktit të drejtpërdrejtë i siguruar me vizita/gosti të ndërsjella ose piknike dhe ekskursionet të përbashkëta. Ndërmjet vizitave, nxënësit nga secila shkollë mund të punojnë veç e veç, e të sigurojnë komunikim me nxënësit nga shkolla partnere përmes ndërmjetimit kompjuterik dhe audio-video takimeve (Skype ose ngjajshëm) si dhe përmes përmes shfrytëzimit të ndonjë platforme për shpërndarjen e dokumenteve (Google dos ose ngjajshëm me te). Ngjajshëm sikurse gjatë realizimit të orëve të lira në shkollat e mesme (të përshkruara më poshtë), ndërmjet takimeve direkte ballë-përballë dhe takimeve të mbështetura përmes kompjuterit, mund të ketë periudhë të punës hulumtuese gjatë së cilës nxënësit nga secila shkollë veçmas mbledhin informata në terren, të cilat pastaj i shkëmbejnë ndërmjet veti që të vijë deri te produkti i përbashkët.

Sipas planit mësimor për arsim gjimnazor, të përgatitur nga ana e Birosë për zhvillimin e arsimit, projekt aktivitetet mund të organizohen rreth lëmive vijuese: kultura e e jetës së shëndetëshme, paqja dhe toleranca, kultura urbane, kultura qytetare, aktivitete sportive, aktivitete nga lëmi i muzikës, aktivitete figurative-krijuese, klube letrare dhe seksione të dramës, ndërmarrësi etj.

Mësimdhënësit, nga të dy shkollat, dakordohen për një lëmi të përbashkët dhe pastaj në takimin e parë të përbashkët me nxënësit nga të dy shkollat zgjedhet tema konkrete në të cilën do të punojnë në projekt aktivitetet me temë të tillë, dhe gjithashtu mund të zbatojnë edhe anketë në mes nxënësve që t'i njohin preferencat e nxënësve për tema të mundshme rreth së cilave do të organizoheshin projekt aktivitetet.

#### **Përgatitja**

Nga çifti i mësimdhënësve nga të dy shkollat partnere të cilat së bashku do të udhëheqin projekt aktivitetet pritet:

- së bashku të përgatisin program me aktivitete konkrete për realizimin e projekt aktivitetëve me përbërje të përziera etnike të nxënësve nga të dy shkollat;
- të formojnë grup etnik dhe gjinor të balancuar me numër të përgjithshëm prej 20-24 nxënës (nga 10-12 nxënës nga secila shkollë);
- t'i sigurojnë kushtet teknike të domosdoshme për realizimin e orëve të lira (hapsirë me së paku 4 kompjuterë me internet pa ndërprerje dhe audio-video lidhje);
- të përcaktojnë termin (kohën dhe vendin) për realizimin e projekt aktivitetëve dhe të njejtin në formë të shkruar ta vendosin në vend të dukshëm;
- t'i sigurojnë materialet e nevojshme për realizimin e projekt aktivitetëve, dhe
- në secilin takim (të përbashkët ose veçmas) t'i paraprijë dakordimi i përbashkët për përshtatjen e realizimit të aktivitetëve.

## Realizimi

Gjatë realizimit të orëve për projekt aktivite mësimdhënës nga të dy shkollat partnere duhet t'i respektojnë drejtimet vijuese:

- të flasin kryesisht në atë gjuhë mësimore në të cilën ligjërojnë, por të mundësojnë që gjuha të shihet si mjet për lehtësimin e komunikimit të ndërsjellë;
- gjatë plotësimit të materialeve punuese të shfrytëzohen të dy gjuhët ( të sigurohet përkthim në gjuhën tjetër përmes Google translate);
- gjatë komunikimit të ndërsjellë të dy gjuhët të përdoren në mënyrë reciproke ( njëra gjuhë të të mos shërbejë vetëm për përkthim);
- sipas nevojave të aktiviteve të planifikuara, t'i organizojnë nxënësit në çifte ose ekipe të përziera etnike/gjuhësore të cilët së bashku duhet të kryejnë detyrë të caktuara në kontakt të drejtpërdrejtë ose përmes komunikimit të mbështetur kompjuterik, dhe
- gjatë prezentimit eventual të produkteve nga aktivitetet e përbashkëta, ftesat dhe katalogu për ekspozitën, si dhe tekstet nën fotografi t'i shkruajnë në të gjitha gjuhët e përfaqësuara gjatë prezentimit të aktiviteve.

### ORËT E LIRA NË SHKOLLAT PROFESIONALE

Orët e lira të cilat janë të parashikuara në planin mësimorë për arsimin e mesëm profesional mund të organizohen edhe në grupe të përziera, me nxënës nga të dy shkollat partnere me gjuhë mësimore të ndryshme. Në rast të tillë, orët e lira realizohen në mënyrë bilinguale, të udhëhequra nga dy mësimdhënës që ligjërojnë në gjuhë të ndryshme mësimore.

Siç është e definuar në Udhëzuesin për përgatitjen e programeve për orë të lira të shkollës në arsimin e integruar<sup>13</sup>, programet për orët e lira i përgatisin vet mësimdhënësit nga shkollat, dhe gjatë kësaj mund të zgjedhin dy qasje të ndryshme ( më detajisht të përshkruara në pjesën që i kushtohet orëve të lira në shkollat me më shumë gjuhë mësimore). Duke marrë parasysh në atë se qasja e parë mund ta zgjedhin vetëm shkollat në të cilat ka profesione/profile arsimore, më i përshtatshëm për realizim në shkollat me raporte partneriteti është qasja e dytë, për të cilën nuk është aspak e rëndësishme profesioni/profili arsimor, por nevoja që nxënësit nga gjuhët e ndryshme mësimore të vehen në situatë për të përvetësuar përmbajtjet multietnike/multikulturore të cilat promovojnë dygjuhësi, respektim të dallimeve dhe bashkëpunim të ndërsjellë.

Mënyra e realizimit të orëve të lira me nxënës nga shkollat partnere mund të jetë kombinim nga kontakti direkt (ballë-për-ballë) dhe kontakti i ndërmjetësuar, komunikim i ndërmjetësuar kompjuterik. Me këtë rast, modeli optimal do ta ndiqte dinamikën vijuese:

- **faza e parë: kontakti direkt** (ballë- për- ballë)  
Nxënësit nga njëra shkollë partnere realizojnë vizitë/gosti në shkollën tjetër (ose ekskursion të përbashkët), dhe me këtë rast realizohet punëtori në të cilën nxënësit njihen në mes veti përmes aktiviteve interaktive në formë loje.
- **faza e dytë: kontakt i ndërmjetësuar** (komunikimi me ndihmën e kompjuterit)  
Nxënësit nga të dy shkollat partnere në termin të njetë mbajnë takim ( secili në shkollën e tij), gjatë së cilës është i siguar kontakt, audio dhe video lidhje përmes kompjuterit ( Skype ose ngjajshëm me te) si dhe ndonjë platformë për shkëmbimin e dokumenteve (Google dos e ngjajshëm me te). Gjatë kohës së orës, secili grup nga të dy shkollat partnere së pari punon në detyra të caktuara përmes listave punuese të cilat pastaj shkëmbehen me grupin tjetër dhe kështu për të gjitha punët fitohen dy perspektiva/përgjigje të cilat mëpastaj, në varësi nga lloji i programit dhe aktiviteve programore, mund të realizohen, të gjenden ngjajshëmri dhe dallime etj.
- përmes fazës së parë dhe të dytë mund të ketë periudhë të punës hulumtuese gjatë së cilës nxënësit nga secila shkollë veçmas mbledhin informata në terren (varësisht nga lloji i programit).

<sup>13</sup> Udhëzuesi për përgatitjen e programeve për orë të lira të shkollës në arsimin e integruar është i përgatitur nga ana e Qendrës për arsim profesional dhe trajnim në kuadër të projektit „Mësojmë së bashku“ të Ambasadës së mbretërisë së Norvegjisë në bashkëpunim me Ministrinë për arsim dhe shkencë.

## Përgatitja

Nga çifti i mësimdhënësve nga të dy shkollat partnere të cilat së bashku do i udhëheqin orët e lira pritet:

- së bashku ta përgatisin programin për realizimin e orëve të lira me përbërje të përzier të nxënësve nga gjuhë të ndryshme mësimore;
- ta prezantojnë programin për orën e Bashkësisë së klasës para nxënësve dhe të mundësojnë paraqitjen e nxënësve sipas kriteriumeve të dakorduara paraprakisht;
- t'i zgjedhin nxënësit nga shkolla e „tyre“ të cilët do të marrin pjesë në programin e ofruar – të formojnë dy grupe të veçanta ( nga një për secilën shkollë) me nga 10-12 nxënës në secilën ( dhe me numër afërsisht të njëjtë të djemve dhe vajzave në të dy grupet)
- t'i sigurojnë kushtet teknike të domosdoshme për realizimin e orëve mësimore ( hapësirë me më së paku 4 kompjutorë me lidhje të pandërprerë audio-vizuale);
- të përcaktojnë termin ( kohën dhe vendin) për realizimin e orëve të lira të cilën do ta theksojnë në formë të shkruar në vend të dukshëm ( orët e lira mund të organizohen edhe si bllok orë, dy orë në një termin dhe mundet të realizohen gjatë kohës së vikendit), dhe
- secilit takim të përbashkët t'i paraprijë dakordimi i përbashkët për përshtatjen e realizimit të aktiviteteve

## Realizimi

Gathtë realizimit të orëve, mësimdhënësit nga të dy shkollat partnere duhet të kenë kujdes në drejtimet vijuese:

- të flasnin kryesisht në atë gjuhë në të cilën ligjërojnë, por të mundësojnë që gjuha të konsiderohet si mjet për lehtësimin e komunikimit të ndërsjellë;
- gjatë plotësimit të materialeve punuese të përdoren të dy gjuhët ( të sigurohet përkthim në gjuhën tjetër përmes Google translate);
- gjatë komunikimit të ndërsjellë të dy gjuhët të përdoren në mënyrë reciproke dhe të barabartë ( njëra gjuhë të mos shërbejë vetëm për përkthim);
- sipas nevojave të aktiviteteve të planifikuara, t'i organizojnë nxënësit në çifte ose ekupe të përziera etnike/gjuhësore të cilët së bashku duhet të kryejnë detyrë të caktuar në kontakt të drejtpërdrejtë ose përmes komunikimit të ndërmjetësuar me kompjutorë, dhe
- gjatë prezentimit eventual të produkteve nga orët e përbashkëta, ftesat dhe katalogu për ekspozitë, si dhe tekstet nën fotografi t'i shkruajnë në të gjitha gjuhët mësimore të përfaqsuara në shkollat partnere.

### Shembull për tema për orë të lira në shkolla partnere

Hulumtimi i zakoneve të dasmës nga dy etnitete (i paraqitur në pjesën të dedikuar për orë të lira në shkolla me më shumë gjuhë) mund të realizohet në atë mënyrë që nxënësit nga të dy shkollat partnere së pari do të dakordojnë metodologji të grumbullimit të të dhënave në lidhje me kohëzgjatjen e dasmës, ceremoninë, misafirët, muzikën, zakonet, veshjen etj. Pastaj, përmes bisedave me pjesëtarë të bashkësisë së vet nga gjenerata të ndryshme, nga regjione të ndryshme dhe nga statuse sociale të ndryshme, do t'i sigurojnë të dhënat e nevojshme për bashkësinë e tyre etnike. Në fund, rezultatet e fituara nga hulumtimi në terren do të mund t'i analizojnë bashkërisht – të kërkojnë ngjajshmëri dhe dallime, të cilat pastaj mund t'i tregojnë përmes ekspozitave të fotografive, broshurave etj.